




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Municipality of Prizren



Kontratë Koncesioni për projektin:
PARTNERITETI PUBLIKO PRIVAT
VARREZAT E REJA NË FSHATIN LANDOVICË TË PRIZRENIT

NENI I – PËRKUFIZIMET DHE INTERPRETIMI.....	7
1. Përkufizimet.....	7
2. Shtojcat.....	12
3. Titujt dhe nenet.....	12
4. Trashëgimtarët dhe cesionarët e lejuar.....	12
5. Renditja e dokumenteve.....	12
NENI II – KONCESIONI.....	13
1. Të drejtat e koncesionarit.....	13
2. Të drejtat pronësore.....	14
2.1 Vendndodhja.....	14
2.2 Objekti.....	14
NENI III – KOHËZGJATJA E KONTRATËS.....	14
NENI IV – SHPËRBLIMI.....	14
NENI V – TARIFAT.....	14
1. Caktimi i tarifës.....	14
2. Arkëtimi.....	15
3. Të hyrat nga qiraja, parkingu apo të hyra të tjera të lejuara.....	15
NENI VI – PARAKUSHTET E KONTRATËS.....	15
1. Parakushtet e kontratës.....	15
2. Parakushtet që duhet të përmbushen nga koncesionari.....	16
3. Parakushtet që duhet të përmbushen nga komuna.....	17
4. Vërtetimi i datës efektive.....	17
5. Mospërmbushja e parakushteve.....	17
6. Përgjegjësia juridike.....	17
7. Periudha kalimtare.....	17
NENI VII – DETYRIMET E KONCESIONARIT.....	18
1. Detyrimi i përgjithshëm.....	18
2. Vendndodhja.....	18
3. Punët ndërtimore.....	19
4. Shërbimet.....	21
5. Operimi dhe mirëmbajtja e objektit.....	22
6. Nënkontraktimi.....	23
7. Raportimi.....	24
8. Mbajtja e aksioneve.....	25
9. Distribucionet financiare.....	25
10. Caktimi i auditorit.....	25
11. Qëllimi i vetëm.....	25
12. Pagesat.....	26
13. Inspektimet.....	26
14. Sigurimi për përmbushje.....	26
15. Emërtimi i objekteve.....	26
16. Veprimtaritë e ndaluara.....	26
17. Filialet.....	26
NENI VIII – DETYRIMET E KOMUNËS.....	27
NENI IX – GARANCITË.....	27
NENI X – PËRGJEGJËSIA JURIDIKE DHE DËMSPËRBLIMI.....	28
1. Përgjegjësia për palë të treta.....	28
2. Mospërmbushja e detyrimeve.....	29
3. Përgjegjësia për dëme mjedisore.....	29

R.G 

4.	Përgjegjësia për kërkesat e palëve të treta	29
5.	Përgjegjësia për posedim të qetë	30
6.	Kufizimi i përgjegjësisë	30
NENI XI – SIGURIMI I KONTRATËS		30
1.	Sigurimi i kontratës	30
2.	Ekzekutimi i sigurimit të kontratës	31
NENI XII – POLICAT E SIGURIMIT		31
1.	Policat e sigurimit	31
2.	Komuna si përfituese	32
3.	Mungesa e përgjegjësisë së Komunës për mos-sigurim	32
4.	Ndryshime	32
5.	Përfundimi	32
NENI XIII – FUQIA MADHORE		31
1.	Përkufizimi i fuqisë madhore	32
2.	Raportimi i rastit të fuqisë madhore	33
3.	Pasojat e rastit të fuqisë madhore	33
4.	Kompensimi	34
NENI XIV – NGJARJE POLITIKE		34
1.	Ngjarje politike	34
2.	Njoftimi	34
3.	Shfajësimi për mospërbushje	34
NENI XV – SHKËPUTJA E KONTRATËS		35
1.	Shkëputja e kontratës për shkak të fuqisë madhore ose të ngjarjes politike	35
2.	Shkëputja e kontratës nga Komuna	35
3.	Shkëputja e kontratës nga koncesionari	36
4.	Pasoja e shkëputjes së kontratës	36
5.	Kompensimi në rast të shkëputjes së kontratës	37
NENI XVI – DORËZIMI I OBJEKTIT		37
1.	Plani i dorëzimit	37
2.	Shpenzimet e dorëzimit	38
3.	Kushtet e dorëzimit	38
4.	Inspektimi i dorëzimit	38
5.	Shkëputja e kontratave	39
6.	Shuarja e koncesionit	39
NENI XVII – CEDIMI (BARTJA) E KONTRATËS		39
1.	Cedimi	39
2.	Krijimi i mjeteve siguroese	39
NENI XVIII – ZËVENDËSIMI I KONCESIONARIT		39
NENI XIX – E DREJTA E KOMUNËS PËR TË NDËRHYRË		40
1.	E drejta e ndërhyrjes	40
2.	Njoftimi	40
3.	Pasojat e ndërhyrjes	41
NENI XX – ZGJIDHJA E KONTESTEVE		42
1.	Zgjidhja me marrëveshje	42
2.	Arbitrazhi	42
NENI XXI – E DREJTA E ZBATUESHME		42
NENI XXII – HEQJA DORË NGA IMUNITETI		42
NENI XXIII – DISPOZITA TË NDRYSHME		43

1.	Primati i kësaj kontrate	43
2.	Tërësia e kontratës	43
3.	Konfidencialiteti	43
4.	Ndryshimi i kontratës	44
5.	Kamata për vonesë	44
6.	Mospërfitimi nga palë të treta	44
7.	Ndarja e dispozitave	44
8.	Tatimet	45
9.	Njoftimet	45
10.	Gjuha	46
11.	Kufizimi i përgjegjësisë	46
12.	Përfshirja e përgjegjësisë	46
Shtojca 1.	Lokacioni i Varrezave të reja.....	46
Shtojca 2.	Specifikimet e Puneve Instaluese	50
Shtojca 3.	Shërbimet e kërkuara.....	54
Shtojca 4.	Standardet e shërbimit.....	55
Shtojca 5.	Indikatorët kyq të përfomancës.....	57
Shtojca 6.	Qertifikata për përfundimin e punëve fillestare instaluese.....	58
Shtojca 7.	Qertifikata për përfundimin e punëve finale instaluese.....	59
Shtojca 8.	Qertifikata për posedimin e qetë.....	60
Shtojca 9.	Opinionimi ligjor i koncensionarit.....	61
Shtojca 10.	Planimi i tarifave të ofrimit të shërbimit.....	63
	Nënshkrimi i kontratës	63

KONTRATË KONCESIONI

Kjo kontratë koncesioni është lidhur me datën ~~23.2.2017~~ në Prizren midis

1. Komunës së Prizrenit, adresa rr. Remzi Ademi p.n, Zyra e Kryetarit, (në tekstin vijues "Komuna") dhe

2" PZ group " SH.P.K. shoqëri tregtare e themeluar dhe e regjistruar sipas ligjeve të Republikës së Kosovës, adresa Rr. "REMZI ADEMAJ" NR.34, PRIZREN (në tekstin vijues "Koncesionari").

Duke marrë parasysh që

- a. Në pajtim me Ligjin nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 17, Komuna ka kompetenca të plota dhe ekskluzive për planifikimin urban dhe rural si dhe shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin.
- b. Sipas Ligjit Nr. 04/L- 045 për Partneritetet Publike-Private, neni 65, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Komuna është e autorizuar të hyjë në një partneritet publik-privat për rregullimin e infrastrukturës së kompleksit të varrezave.
- c. Me Vendim nr. Nr. 01/06-4271 të datës 30 Qershor 2009, Kuvendi Komunal i Komunës së Prizrenit ka autorizuar për arsyeshmëri për projektin e rregullimit të infrastrukturës së varrezave përmes Partneritetit Publiko Privat.
- d. Në pajtim me Ligjin Nr. 04/L- 045 për Partneritetet Publike-Private, neni 65, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Komiteti Drejtues Ndër-Ministror për Partneritete Publiko-Private e ka miratuar projektin me Nr. Vendimi 15/09 të datës 28.12.2015.
- e. Në pajtim me Ligjin Nr. 04/L- 045 për Partneritetet Publike-Private, neni 65, Komuna e filloi procedurën e prokurimit nr. PPP – 16 085 611 për dhënien e kësaj kontrate duke publikuar njoftimin e kërkesës për kualifikim me datën 20. 05. 2016. Duke iu përgjigjur kësaj kërkesë për kualifikim, ofertuesi parashtri kualifikimet e tij me datën 14.06.2016
- f. Me datën 11.07.2016, Komuna i publikoi rezultatet e procedurës së kualifikimit duke konfirmuar se ofertuesi i ka plotësuar të gjitha kriteret për kualifikim të përcaktuara në kërkesën për kualifikim dhe për këtë arsye është përzgjedhur si "ofertues i kualifikuar".
- g. Me datën 19. 08. 2016, Komuna ia dërgoi kërkesën për propozime të gjithë ofertuesve të kualifikuar.
- h. Me datën 04.10.2016 ("data e dorëzimit të ofertës"), ofertuesi e dorëzoi ofertën e tij në përgjigje ndaj kërkesës për propozime.

- i. Me datën 26.11.2016 procedura e prokurimit për projektin u përbyll duke e caktuar Konsorciumin e përbërë prej kompanive: 1. "EUROVIA" SHPK, 2."JEOHONA" SHPK dhe 3."PROING" si "ofertues të përzgjedhur".
- j. Me datën 25.11.2016, ofertuesi i përzgjedhur themeloi dhe regjistroi " PZ group " SH.P.K. sipas ligjeve të Republikës së Kosovës, qëllimi i së cilës është përbushja e detyrimeve që rrjedhin nga kjo kontratë.

Komuna dhe Koncesionari janë pajtuar si në vijim:

1. NENI I – PËRKUFIZIMET DHE INTERPRETIMI

1.1. Përkufizimet

Në lidhje me këtë kontratë vlejné përkufizimet vijuese, përveç nëse lënda ose konteksti kërkojnë interpretim tjetër:

Autoritet publik	Nënkupton çdo institucion, agjenci, ministri, komunë ose person tjetër, i cili ushtron kompetenca ekzekutive, administrative, legjislativë ose gjyqësore në Republikën e Kosovës në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
Data efektive	Nënkupton datën kur të gjitha kushtet paraprake të përcaktuara në nenin VI janë përmbushur ose është hequr dorë nga përmbushja e tyre, gjë që dëshmohet me nënshkrimin nga palët të certifikatës së datës efektive;
Data e kontratës	Nënkupton datën e nënshkrimit të kësaj kontrate nga Komuna dhe koncesionari;
Data e skadimit	Nënkupton datën e skadimit të kësaj kontrate;
Data e shkëputjes	Nënkupton datën e shkëputjes së kësaj kontrate;
Derdhja e kapitalit aksionar	nënkupton (i) çdo kontribut aksionar që mund t'i jetë kthyer pjesërisht ose tërësisht një aksionari ose personi të asociuar me aksionarin, (ii) çdo dividendë ose pagesë tjetër të paguar nga koncesionari në dobi të një aksionari ose të një personi të asociuar me aksionarin në lidhje me një kontribut aksionar, (iii) çdo shumë e paguar nga koncesionari në dobi të një aksionari ose të një personi të asociuar me aksionarin në formë të interesit, rentës ose premisë në

lidhje me kontributin aksionar dhe (iv) çdo shumë tjetër e paguar nga koncesionari në dobi të një aksionari, një personi të asociuar me aksionarin ose një personi të tretë në të cilin koncesionari mund të ketë në pronësi drejtpërdrejtë ose në mënyrë të tërthortë aksione ose forma të tjera të kapitalit aksionar, përveç shumave të paguara në vlerë të tregut për mallëra të shitura ose shërbime të kryera në bazë të kontratës dhe në kuadër të veprimtarisë së rregullt afariste në dobi të koncesionarit nga një aksionar, një person i asociuar me një aksionar ose një person tjetër;

Dëmi mjedisor

Ka kuptimin e përcaktuar në Ligjin No. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit;

Ditë pune

Nënkupton çdo ditë e cila nuk është ditë e shtune, e diele ose ditë e caktuar si festë zyrtare në Republikën e Kosovës;

Dokumenti i Specifikimeve Teknike

Nënkupton dokumentin e bashkëngjitur si Shtojca 2, përfshirë të gjitha ndryshimet, plotësimet dhe azhurnimet për të cilat pajtohen Komuna dhe koncesionari dhe të cilat janë pjesë përbërëse e Shtojcës 2;

Doracaku për operim dhe mirëmbajtje

Nënkupton doracakun që do të përpilohet nga koncesionari, në të cilin do të përcaktohen procedurat, oraret, planet, udhëzimet dhe afatet për operimin dhe mirëmbajtjen e objektit;

Emergjencë

Nënkupton gjendjen ose situatën e cila paraqet rrezik për objektin ose kur ka gjasa që mund të shkaktohet lëndimi trupor ose vdekja e një personi ose të dëmtohet objekti;

EURIBOR

Nënkupton EURIBOR normën për 12 muaj të publikuar zyrtarisht nga Banka Qendrore Evropiane;

Indikatorët kryesor të performancës

Nënkupton objektivat, parametrat dhe indikatorët tjerë të

dhe indikatorët tjerë të performancës të përcaktuara në

Aneksin 4;

Kërkesa për kualifikime (KpK)	Nënkupton dosjen e tenderit për kërkesën për kualifikime të nxjerrë nga Komuna me datën <u>20.05.2016</u>
Kërkesa për propozime (KpP)	Nënkupton dosjen e tenderit të kërkesës për propozime të nxjerrë nga Komuna me datën <u>19.08.2016</u>
Kohëzgjatja	Nënkupton kohëzgjatjen e kësaj kontrate të përcaktuar në nenin III, duke marrë parasysh mundësinë e vazhdimit dhe shkëputjes së saj sipas kësaj kontrate;
Kontrata e financimit	Nënkupton çdo kontratë e cila lidhet midis koncesionarit dhe një ose më shumë kredidhënësve para ose në datën efektive në lidhje me financimin e projektit përmes kredisë dhe në dobi të koncesionarit si dhe çdo kontratë që ka të bëjë me rifinancimin e kësaj;
Kontributi aksionar	Nënkupton çdo kontribut aksionar në formë të parave të gatshme në dobi të koncesionarit si dhe çdo kredi dhe parapagesë në dobi të koncesionarit nga një aksionar ose një person i asociuar;
Leje	Nënkupton çdo akt administrativ, vendim, autorizim, pëlqim, licencë, leje, përjashtim, heqje dorë, certifikatë ose regjistrim që përmban një akt administrativ i cili është nxjerrë nga Republika e Kosovës ose nga një autoritet i saj publik para ose në datën e kësaj kontrate në lidhje me këtë kontratë ose projektin, si dhe çdo akt administrativ, vendim, autorizim, pëlqim, licencë, leje, përjashtim, heqje dorë, certifikatë ose regjistrim të Republikës së Kosovës ose të një autoriteti të saj publik që duhet të merret, mbahet ose të vazhdohet sipas ligjeve dhe rregulloreve që vlejnë për projektin ose sipas një kontrate që lidhet në lidhje me projektin;
Objekti/et	Nënkupton objektet që janë pjesë përbërëse e projektit

	të varrezave të reja të Komunës";
Person	Nënkupton çdo person fizik dhe juridik;
Person i asociuar	Nënkupton çdo person i cili drejtpërdrejtë ose tërthorazi kontrollohet nga një person tjetër; për nevojat e këtij përkufizimi, kontrollë nënkupton mundësinë për të drejtuar drejtpërdrejtë ose tërthorazi menaxhimin dhe objektivat e një personi, qoftë përmes aksioneve me të drejtë vote, qoftë përmes kontratës ose në ndonjë formë tjetër;
Plani i financimit	Nënkupton planin e përpiluar nga koncesionari në formë shkresore për financimin e projektit, i cili specifikon, ndër të tjera, (i) burimet dhe qëllimin e shfrytëzimit të financimit, (ii) totalin e kostove të paralogaritura të projektit, (iii) kohën dhe shumën e financimit të koncesionarit përmes kapitalit aksionar dhe kredisë, duke përfshirë shumën e kapitalit aksionar që do të kontribuohet në datën efektive nga aksionarët në dobi të koncesionarit, dhe (iv) numrin total të aksioneve me të drejtë vote të koncesionarit të cilat do të jenë të autorizuara në datën efektive si dhe përqindjen e secilit aksionar në lidhje me këto aksione;
Plani i punëve ndërtimore	Nënkupton planin në formë shkresore të përpiluar nga koncesionari për kryerjen e punëve ndërtimore;
Posedim i qetë	Nënkupton të drejtën e shfrytëzimit të vendndodhjes për qëllimet e projektit pa u penguar nga një person i tretë dhe pa ndonjë kërkesë monetare që mund të jetë parashtruar para datës efektive;
Projekt	Nënkupton (i) kryerjen e shërbimeve në pajtim me këtë kontratë (ii) projektimin, financimin, ndërtimin dhe përfundimin e objektit në vendndodhje, dhe (iii) operimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e objektit;
Projekti ideor i ndërtimit	Ka kuptimin e përcaktuar në ligjin përkatës për ndërtimin;
Projekti kryesor i ndërtimit	Ka kuptimin e përcaktuar në ligjin përkatës për ndërtimin;
Projekti i objektit të ndërtuar	Ka kuptimin e përcaktuar në ligjin përkatës për ndërtimin;

Punët ndërtimore	Nënkupton të gjitha punët lidhur me projektimin, ndërtimin dhe përfundimin e objektit;
Qira	Nënkupton pagesën në para të arkëtuar dhe mbledhur nga koncesionari nga persona të tjerë si shpërblim për dhënien në shfrytëzim të hapësirës komerciale ose të pjesëve të saj;
Raporti i vlerësimit mjedisor	Nënkupton raportin e shkruar të përpiluar nga koncesionari në të cilin identifikohen dhe specifikohen të gjitha dëmet mjedisore që ekzistojnë në vendndodhje para datës efektive;
Standardet	Nënkupton standardet e përcaktuara dhe të zbatueshme në Republikën e Kosovës lidhur me punët ndërtimore, pajisjet, proceset teknike dhe mbrojtjen e mjedisit;
Shërbimet	Nënkupton shërbimet e përcaktuara në Aneksin 3. që do të kryhen nga koncesionari;
Tarifë e shërbimit	Nënkupton pagesën monetare e cila arkëtohet nga koncesionari nga shfrytëzuesit si shpërblim për kryerjen e shërbimeve nga koncesionari në bazë të kësaj kontrate
Ndihma shtetërore për PPP	Nënkupton ndihmën shtetërore në formë të mbështetjes financiare nga Autoriteti Kontraktues/Komuna për projektin, sipas përkufizimeve në nenin 12 të Ligjit nr. 04/L-045 Për partneritet publiko privat, e paguar nga Autoriteti Kontraktues tek Koncesionari në përputhje me afatet dhe kushtet të parapara në nenin IV pika 4.1 kësaj Kontrate;
Vendndodhja	Nënkupton tokën, hapësirën dhe sipërfaqen e përshkruar në Aneksin 1;

R.G 

1.2. Shtojcat

1.2.1 Shtojcat vijuese janë pjesë përbërëse të kësaj kontrate:

- SHTOJCA 1. Vendndodhja PZ PPP-09-13
- SHTOJCA 2. Specifikimet e punimeve instaluese
- SHTOJCA 3. Shërbimet e kërkuara
- SHTOJCA 4. Standardet e shërbimit
- SHTOJCA 5. Indikatorët kyç të performancës
- SHTOJCA 6. Çertifikata për përfundimin e punëve fillestare
- SHTOJCA 7. Çertifikata për përfundimin e punëve finale instaluese
- SHTOJCA 8. Çertifikata për posedimin e qetë
- SHTOJCA 9. Opinioni ligjor i koncensionarit
- SHTOJCA 10. Plani i tarifave të ofrimit të shërbimit

1.2.2 Çdo referencë në shtojcë nënkupton një shtojcë të kësaj kontrate, përveç nëse është përcaktuar ndryshe.

1.3 Titujt dhe nenet

1.3.1 Titujt e neneve të kësaj kontrate shërbejnë vetëm për qëllime të referencave dhe në asnjë mënyrë nuk ndikojnë në interpretimin e kësaj kontrate.

1.3.2 Çdo referencë në nene ka të bëjë me nene të kësaj kontrate, përveç nëse është përcaktuar ndryshe në kontratë.

1.4 Trashëgimtarët dhe cesionarët e lejuar

Çdo referencë në një palë ose person përfshinë edhe trashëgimtarët dhe cesionarët e tyre të lejuar.

1.5 Renditja e dokumenteve

1.5.1 Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në këtë kontratë, çdo kolizion ose papajtueshmëri midis dispozitave të kësaj kontrate, KPK, KPP, propozimit të ofertuesit të dorëzuar si përgjigje ndaj KPP si dhe dokumentit të specifikimeve teknike zgjidhet konform hierarkisë së dokumenteve si në vijim:

- (i) Kontrata;
- (ii) KpP;
- (iii) KpK;
- (iv) Propozimi në përgjigje ndaj KpP; dhe
- (v) Dokumenti i specifikimeve teknike.

1.5.2 Në rast të një kolizioni ose papajtueshmërie midis dispozitave të kësaj kontrate dhe shtojcave të saj, kontrata ka epërsi, me përjashtim të dokumentit të specifikimeve teknike, i cili ka epërsi në raport me kontratën.

1.5.3 Në rast të një kolizioni ose papajtueshmërie midis dispozitave të kësaj kontrate dhe KPK, kontrata ka epërsi, me përjashtim të kushteve minimale të kualifikimit të përcaktuara në KPK, të cilat kanë epërsi ndaj kontratës.

1.5.4 Në rast të një kolizioni ose papajtueshmërie midis dispozitave të kësaj kontrate dhe KPP, kontrata ka epërsi, me përjashtim të procedurës së tenderimit, lidhur me të cilat dispozitat e KPP kanë epërsi.

NENI II – KONCESIONI

2.1 Të drejtat e koncesionarit

2.1.1 Komuna ia bartë koncesionarit të drejtën ekskluzive si dhe e obligon koncesionarin që gjatë kohëzgjatjes së kontratës dhe sipas kushteve të kësaj kontrate (i) të kryej shërbimet e përcaktuara në këtë kontratë, (ii) të projektojë, financojë, ndërtojë dhe përfundojë objektin në vendndodhje, (iii) të operojë, menaxhojë dhe mirëmbajë objektin dhe (iv) të arkëtojë tarifën e parapara me rregulloren e Rregulloren për Varrim dhe Mirëmbajtjen e Varrezave dhe tarifën e qirasë për objektet e lejuara për dhënie me qira apo edhe të hyrat tjera të lejuara me këtë kontratë.

2.1.2 Për nevojat e ndërtimit, operimit dhe mirëmbajtjes së objektit dhe për tërë kohëzgjatjen e projektit, Komuna po ashtu ia bartë koncesionarit të drejtën e shfrytëzimit lidhur me patundshmërinë e cila e përbën vendndodhjen.

2.1.3 Gjatë kohëzgjatjes së kontratës, koncesionari ka të drejtën ekskluzive për të ushtruar të drejtat e koncesionarit të përcaktuara në këtë kontratë. Komuna zotohet se nuk do t'ia bartë ose cedojë ndonjë personi tjetër në çfarëdo forme, me apo pa shpërblim, të drejtat e koncesionarit ose ndonjë prej detyrimeve të koncesionarit sipas kësaj kontrate, përveç nëse me kontratë është përcaktuar ndryshe.

2.2 Të drejtat pronësore

2.2.1 Vendndodhja

Komuna e ka dhe e mbanë të drejtën pronësore mbi patundshmërinë e cila përbën vendndodhjen. Koncesionari nuk e ka dhe nuk e fiton të drejtën pronësore mbi patundshmërinë e cila përbën vendndodhjen.

2.2.2 Objekti

Komuna e fiton dhe e mbanë të drejtën pronësore mbi objektet e ndërtuar në vendndodhje nga koncesionari. As koncesionari, e as ndonjë nën-kontraktues i koncesionarit, e as ndonjë person i tretë nuk e fiton të drejtën e pronësisë mbi objektet në fjalë. Koncesionari e fiton dhe e mban të drejtën e shfrytëzimit lidhur me objektet deri në datën e skadimit ose datën e shkëputjes, cilado që ndodhë më herët. Që nga data e skadimit ose data e shkëputjes, cilado që ndodhë më herët, koncesionari ia kalon Komunës posedimin mbi objektet.

NENI III – KOHËZGJATJA E KONTRATËS

Kohëzgjatja e kontratës është një periudhë kohore prej 30 viteve që nga data efektive. Kohëzgjatja e kontratës mund të vazhdohet në pajtim me Ligjin për PPP (LIGJI Nr. 04/L-045), neni 9.2, dhe sipas kushteve për të cilat janë pajtuar Komuna dhe koncesionari.

NENI IV – SHPËRBLIMI

Si shpërblim për dhënien e të drejtës së koncesionit, Koncesionari ka për detyrë t'i kryej shërbimet e menaxhimit të hapësirës së varrezave të përcaktuara në shtojcën 3 gjatë tërë kohëzgjatjes së projektit ku përveç të hyrave të arkëtuara nga shërbimet, Komuna do të kryej pagesën vjetore të paraparë si rezultat i ofertës me kërkesë më të ultë të mbështetjes ekonomike.

NENI V – TARIFAT

5.1 Caktimi i tarifës

Koncesionari ka të drejtë të arkëtojë tarifa e shërbimit në pajtim me Rregulloren për Varrim dhe Mirëmbajtjen e Varrezave, si shpërblim për menaxhimin dhe operimin me hapësirën e varrezave. Përgjegjësinë dhe rrezikun për pasojat e mundshme nga tarifët e caktuara do ta bart vet partneri privat. Poashtu, koncesionari do të ketë të drejtë të arkëtojë të hyra nga dhënia me qira e pjesës së paraparë komerciale.

5.2 Arkëtimi

5.2.1 Koncesionari ka të drejtë, si dhe është ekskluzivisht dhe tërësisht përgjegjës për arkëtimin, mbledhjen, pranimin, depozitimin dhe mbajtjen e të gjitha tarifave gjatë kohëzgjatjes së kontratës si dhe e bartë rrezikun në lidhje me këtë. Të gjitha tarifat dhe qiraja arkëtohen dhe mblidhen në Euro në pajtim me ligjin. Koncesionari arkëton tarifat përkatëse nga shfrytëzuesit të cilët kanë hyrë në marrëdhënie kontraktore me koncesionarin në lidhje me ofrimin e hapësirave komerciale në objektet përkatëse me karakter komercial të hapësirës së varrezave, apo edhe të hyra të tjera të lejuara me këtë kontratë.

5.2.2 Në rast se koncesionari nuk e arkëton apo nuk e mbledhë tarifën nga një shfrytëzuesi pasi që të ketë ndërmarrë veprimet e arsyeshme për të arkëtuar apo mbledhur ato, si dhe nëse koncesionari për ndonjë arsye tjetër nuk është në gjendje që të arkëtojë, pranojë, depozitojë ose të mbajë tarifën që duhet të paguhet nga ndonjë shfrytëzues gjatë kohëzgjatjes së kontratës, Komuna nuk ka asnjë përgjegjësi dhe koncesionari nuk ka të drejtë të kërkojë kompensim nga Komuna, përveç nëse Komuna ka për detyrë t'ia paguaj koncesionarit tarifën në bazë të një kontrate.

5.2.3 Pamundësia ose paafësia e koncesionarit për të arkëtuar, mbledhur ose mbajtur tarifën nuk i jep të drejtë koncesionarit që të shkëpusë kontratën, përveç nëse pajtohet ndryshe me Komunën.

5.3. Të hyrat nga qiraja, apo të hyra të tjera të lejuara

Koncesionari ka të drejtë që të mbajë të gjitha të hyrat e realizuara nga qiraja apo aktivitetet e tjera komerciale brenda hapësirës komerciale të lejuar sipas kësaj kontrate.

NENI VI – PARAKUSHTET E KONTRATËS

6.1 Parakushtet e kontratës

Të drejtat dhe detyrimet e palëve sipas kësaj kontrate janë të kushtëzuara me përmbushjen e parakushteve të përcaktuara në këtë kontratë. Parakushtet duhet të përmbushen nga secila palë brenda 90ditëve që nga data e kontratës, përveç nëse palët pajtohen që të shtyjnë afatin ose njëra palë ka hequr dorë me shkrim nga një ose më shumë parakushte që duhet të përmbushen nga pala tjetër.

R.G 

6.2 Parakushtet që duhet të përmbushen nga koncesionari

Të drejtat dhe detyrimet e koncesionarit sipas kësaj kontrate janë të kushtëzuara me përmbushjen e kushteve vijuese:

6.2.1 koncesionari ia ka dorëzuar Komunës dokumentet e cekura në vijim dhe të cilat janë miratuar nga Komuna me shkrim:

plani i financimit;

plani ideor për objektin;

plani i punëve ndërtimore;

raporti i vlerësimit mjedisor;

lejen urbanistike

lejet tjera relevante

6.2.2 koncesionari ia ka dorëzuar Komunës kontratën e financimit, e cila është nënshkruar nga palët e asaj kontrate dhe e cila është miratuar me shkrim nga Komuna, si dhe të gjitha kushtet paraprake të kontratës së financimit janë përmbushur ose është hequr dorë nga përmbushja e tyre, përveç kushtit në lidhje me këtë kontratë;

6.2.3 koncesionari e ka marrë në mënyrë të ligjshme të gjitha lejet dhe licencat nga autoriteti kompetent për kryerjen e shërbimeve sipas kësaj kontrate;

6.2.4 koncesionari ia ka dorëzuar Komunës sigurimin për përmbushjen, i cili duhet të jetë i pranueshëm në formë dhe në përmbajtje nga Komuna dhe i cili duhet të jetë i plotfuqishëm dhe i miratuar me shkrim nga Komuna;

6.2.5 aksionarët i kanë paraqitur Komunës dëshmi të mjaftueshme se shuma e kapitalit aksionar që duhet të kontribuohet nga aksionarët të koncesionari në datën efektive dhe sipas planit të financimit është paguar;

6.2.6 koncesionari ia ka dorëzuar Komunës një mendim juridik nga këshilltari i tij juridik në formën e përcaktuar në Aneksin 7 dhe Komuna e ka miratuar me shkrim këtë mendim juridik.

6.3 Parakushtet që duhet të përmbushen nga Komuna

Të drejtat dhe detyrimet e Komunës sipas kësaj kontrate janë të kushtëzuara me dorëzimin nga ana e Komunës tek koncesionari të një vërtetimi në formën e përcaktuar në Aneksin 6 përmes të cilës Komuna ia konfirmon koncesionarit posedimin e qetë që nga data efektive e kontratës.

6.4 Vërtetimi i datës efektive

Me rastin e përmbushjes së parakushteve, ose të heqjes dorë prej tyre, palët kanë për detyrë të nënshkruajnë një vërtetim përmes së cilës konfirmojnë se të gjitha parakushtet e përcaktuara në këtë nen janë përmbushur ose është hequr dorë nga përmbushja e tyre dhe përmes së cilës caktohet data efektive ("vërtetimi i datës efektive").

6.5 Mospërmbushja e parakushteve

6.5.1 Nëse koncesionari nuk i përmbushë parakushtet dhe Komuna nuk ka hequr dorë nga përmbushja e tyre, Komuna ka të drejtë të shkëpusë kontratën në tërësi dhe të ekzekutojë sigurimin për përmbushjen e kontratës të depozituar nga koncesionari.

6.5.2 Nëse Komuna nuk i përmbushë parakushtet dhe koncesionari nuk ka hequr dorë nga përmbushja e tyre, koncesionari ka të drejtë të shkëpusë kontratën në tërësi. Në këtë rast, Komuna ka për detyrë t'ia kthejë koncesionarit sigurinë për përmbushjen e kontratës.

6.6 Përgjegjësia juridike

Nëse kjo kontratë shkëputet sipas dispozitave të këtij neni, atëherë Komuna nuk ka për detyrë t'ia kompensojë koncesionarit asnjë formë të dëmit të shkaktuar nga shkëputja e kontratës.

6.7 Periudha kalimtare

Gjatë periudhës kohore midis datës së kontratës dhe datës efektive, Komuna pajtohet që t'ia lejojë koncesionarit qasjen e arsyeshme në vendndodhje për të kryer matje dhe testime si dhe për të kryer punë të tjera të nevojshme për të përmbushur parakushtet. Koncesionari ka për detyrë të respektojë të gjitha standardet e sigurisë dhe të mos e pengojë apo të ndërhyjë me trafikun publik në vendndodhje apo pranë saj.

NENI VII – DETYRIMET E KONCESIONARIT

7.1 Detyrimi i përgjithshëm

Koncesionari ka për detyrë që, me shpenzime të veta, të veprojë në pajtim me ligjin gjatë përmbushjes së detyrimeve të tij sipas kësaj kontrate.

7.2 Vendndodhja

7.2.1 Koncesionari ka për detyrë që, me shpenzime të veta, të largojë të gjitha strukturat, ndërtesat dhe objektet tjera që pengojnë kryerjen e punëve ndërtimore në vendndodhje. Në rast se nevojitet ndonjë leje për largimin e strukturave, ndërtesave dhe objekteve që pengojnë kryerjen e punëve ndërtimore në vendndodhje, koncesionari ka për detyrë që, me shpenzime të veta, të sigurojë këto leje nga autoritetet kompetente. Komuna mund tëfasiltoj dhe ndihmoj koncesionarin në marrjen e lejeve përkatëse. Nëse lejet janë kompetencë e autoritetit kontraktues, atëherë autoriteti kontraktues është i obliguar që në një afat sa më të shkurt dhe brenda kornizës ligjore ti ofron lejet e nevojshme për largimin e strukturave në hapësirat e paraparë për varreza.

7.2.2 Koncesionari ka për detyrë që t'ia lejojë Komunës dhe përfaqësuesve të saj qasjen në vendndodhje për nevojat e përcjelljes së punëve të koncesionarit dhe për të siguruar që koncesionari vepron në pajtim me detyrimet e tij sipas kontratës. Komuna ka për detyrë që të respektojë të gjitha standardet e sigurisë dhe të mos pengojë ose të ndërhyjë në punët ndërtimore ose operimin e objektit.

7.2.3 Koncesionari ka për detyrë që, me shpenzime të veta, të kryejë të gjitha matjet dhe hulumtimet në vendndodhje për nevojat e punëve ndërtimore. Komuna nuk ka asnjë përgjegjësi në lidhje me matjet, hulumtimet si dhe punët përkatëse që kryhen nga koncesionari.

7.2.4 Koncesionari pajtohet që çdo fosil, monedhë, send tjetër me vlerë dhe mbetje arkeologjike që zbulohet në vendndodhje është në pronësi të Republikës së Kosovës. Në rast të zbulimit të një sendi të tillë në vendndodhje pas datës efektive, koncesionari ka për detyrë ta njoftojë menjëherë Komunën dhe t'ia lejojë Komunës ose një autoriteti tjetër kompetent qasjen në vendndodhje për të larguar sendin në fjalë. Koncesionari ka për detyrë të përfillë udhëzimet e Komunës dhe të autoritetit kompetent. Nëse sendi i zbuluar është i paluajshëm, koncesionari ka për detyrë t'ia lejojë Komunës ose autoritetit kompetent kryerjen e hulumtimeve që kërkohen me ligj dhe të përfillë udhëzimet e Komunës dhe të autoritetit kompetent lidhur me këtë. Komuna ka për detyrë t'ia



kompensojë koncesionarit të gjitha shpenzimet e arsyeshme dhe të dokumentuara që i janë shkaktuar koncesionarit si pasojë e përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në këtë nen.

7.2.5 Nëse koncesionari është i detyruar me ligj që të ndërmer masa rehabilituese në lidhje me një dëm mjedisor që ka ekzistuar në vendndodhje para datës efektive dhe që është identifikuar dhe specifikuar si i tillë në raportin e vlerësimit mjedisor, atëherë koncesionari ka për detyrë të kryejë masat rehabilituese siç kërkohet me ligj dhe Komuna ka për detyrë që t'ia kompensojë koncesionarit të gjitha shpenzimet e arsyeshme dhe të dokumentuara që i janë shkaktuar koncesionarit si pasojë e përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në këtë nen.

7.3 Punët ndërtimore

7.3.1 Standardet për punët ndërtimore


Koncesionari ka për detyrë që, me shpenzime të veta dhe në rrezik të vetin, të kryejë punët ndërtimore në pajtim me dokumentin e specifikimeve teknike, projektin ideor dhe projektin kryesor të ndërtimit, planin e punëve ndërtimore si dhe në pajtim me ligjin dhe standardet e ndërtimit. Kryerja e punëve ndërtimore nuk guxon të ndërpres ose të pengojë qarkullimin në rrugët publike në vendndodhje apo pranë saj, përveç nëse merret vesh ndryshe me Komunën. Gjatë kryerjes së punëve ndërtimore, koncesionari ka për detyrë të minimizojë ndikimin e punëve ndërtimore tek shitësit dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve që gjenden në afërsi të vendndodhjes.

7.3.2 Përfundimi i punëve ndërtimore

Koncesionari ka për detyrë të fillojë me punët ndërtimore në datën efektive ose pas saj dhe të përfundojë ndërtimore sipas planit dinamik të investimeve të paraqitura në Planin e Biznesit të Koncesionarit, si Faza e parë (50% e investimeve) duhet të realizohet brenda 12 muajve nga data efektive, Faza e dytë (30% e investimeve) brenda 10 viteve nga data efektive dhe Faza e tretë (20% e investimeve) në punët ndërtimore brenda 20 viteve nga data efektive, përveç nëse palët pajtohen ndryshe me shkrim. Gjatë kësaj periudhe kohore, koncesionari ka për detyrë që, me shpenzime të veta, të sigurojë të gjitha lejet që nevojiten për kryerjen e punëve ndërtimore. Me rastin e përfundimit të punëve ndërtimore, palët nënshkruajnë një vërtetim për përfundimin e punëve ndërtimore në formën e përcaktuar në Shtojcën 5 përmes së cilës vërtetohet përfundimi i punëve ndërtimore, me kusht që Komuna vlerëson se punët ndërtimore janë kryer në pajtim me dokumentin e specifikimeve teknike, projektin ideor dhe projektin kryesor të ndërtimit, planin e punës së ndërtimit si dhe në pajtim me ligjin dhe standardet përkatëse.

7.3.3 Dënimet

Nëse koncesionari nuk i përfundon punët ndërtimore brenda afatit të përcaktuar në këtë kontratë, ose brenda afatit tjetër për të cilin janë pajtuar Komuna dhe koncesionari, koncesionari ka për

R.G 

detyrë të paguaj dënim në lartësi prej 1000EUR për secilën ditë që punët ndërtimore nuk janë përfunduar brenda afatit. Komuna ia paraqet koncesionarit faturën për secilën ditë për të cilën duhet të paguhet dënimi. Koncesionari ka për detyrë të paguaj dënimin me rastin e pranimit të faturës. Nëse koncesionari nuk e ka paguar dënimin në tërësi sipas faturës së Komunës, Komuna ka të drejtë të ekzekutojë sigurimin për përmbushjen për të përmbushur detyrimin e koncesionarit për të paguar dënimin.

7.3.4 Projekti kryesor i ndërtimit

7.3.4.1 Koncesionari ka për detyrë të përgatis projektin kryesor të ndërtimit në pajtim me dokumentin e specifikimeve teknike, projektin ideor të ndërtimit dhe planin e punëve ndërtimore. Koncesionari ka për detyrë t'ia dorëzojë Komunës projektin kryesor të ndërtimit për miratim jo më vonë se 45 ditë pas datës efektive. Koncesionari ka për detyrë t'a dorëzojë projektin kryesor të ndërtimit në formën e përcaktuar nga Komuna.

7.3.4.2 Komuna ka të drejtë ta refuzojë projektin kryesor të ndërtimit nëse nuk është në pajtim me dokumentin e specifikimeve teknike, projektin ideor të ndërtimit dhe planin e punëve ndërtimore. Nëse Komuna e refuzon projektin kryesor të ndërtimit në tërësi apo pjesërisht, koncesionari ka për detyrë ta përpunojë projektin kryesor dhe t'ia paraqesë Komunës për miratim projektin kryesor të përmirësuar brenda afatit të caktuar nga Komuna. Kjo procedurë zbatohet deri sa Komuna ta miratojë projektin kryesor të ndërtimit.

7.3.5 Projekti i objektit të ndërtuar

Menjëherë pas përfundimit të punëve ndërtimore dhe nënshkrimit nga të dyja palët të certifikatës për përfundimin e punëve ndërtimore, koncesionari ka për detyrë t'ia dorëzojë Komunës projektin e objektit të ndërtuar në formën e përcaktuar nga Komuna. Pranimi i projektit të objektit të ndërtuar nga Komuna nuk e liron koncesionarin nga përgjegjësitë e tij juridike të përcaktuara në këtë kontratë.

7.3.6 Variacionet

7.3.6.1 Komuna, përkatësisht koncesionari, ka të drejtë të kërkojë me shkrim nga pala tjetër që të zbatojë një variacion. Variacioni nënkupton çdo ndryshim në lidhje me afatin, vëllimin, projektin, cilësinë, formën, karakterin, llojin, pozitën, dimensionin, nivelin ose linjën e punëve ndërtimore si pasojë të një mosveprimi, modifikimi, shtimi, zëvendësimi ose ndryshimi të dokumentit të specifikimeve teknike, projektin ideor, projektin kryesor të ndërtimit ose të planit të punëve ndërtimore.

7.3.6.2 Koncesionari ka për detyrë të zbatojë variacionin e kërkuar nga Komuna. Komuna ka për detyrë të bartë shpenzimet e arsyeshme dhe të dokumentuara të secilit variacion që është kërkuar nga Komuna dhe që është zbatuar nga koncesionari.

7.3.6.3 Komuna mund të miratojë variacionin e kërkuar nga koncesionari. Në këtë rast, koncesionari ka për detyrë të bartë të gjitha shpenzimet e ndërlidhura me zbatimin e variacionit.

7.4 Shërbimet

7.4.1 Vëllimi i shërbimeve

Që nga data efektive e kësaj kontrate, përveç nëse palët merren vesh ndryshe, koncesionari ka për detyrë që, me shpenzime të veta, të kryejë shërbimet gjatë tërë kohëzgjatjes së kontratës në pajtim me indikatorët kryesor të performancës si dhe në pajtim me ligjin, rregulloret dhe standardet tjera të zbatueshme.

7.4.2 Lejet

Koncesionari ka për detyrë që, me shpenzime të veta, të sigurojë të gjitha lejet që nevojiten për kryerjen e shërbimeve

7.4.3 Pajisjet

Koncesionari ka për detyrë që, me shpenzime të veta, të blejë ose sigurojë në sasinë dhe cilësinë e duhur dhe të mirëmbajë në gjendje të rregullt pajisjet që nevojiten për kryerjen e shërbimeve.

7.4.4 Emergjencat

Koncesionari ka për detyrë që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme dhe që kërkohen me ligj për të mbrojtur mjedisin gjatë kryerjes së shërbimeve dhe të minimizojë dëmet dhe trazimet që mund t'u shkaktohen personave dhe pronës së huaj si pasojë dëmeve mjedisore që mund të rrjedhin nga kryerja e shërbimeve.

7.4.5 Dënimet

Në rast se koncesionari nuk i kryen apo i kryen me vonesë shërbimet e përcaktuara në këtë kontratë, ose nëse nuk i kryen shërbimet në pajtim me indikatorët kryesor të performancës, koncesionari ka për detyrë të paguaj dënimin në shumën prej 300 € për secilën ditë të mos-përbushjes ose vonesës. Komuna ia paraqet koncesionarit faturën për secilën ditë për të cilën duhet paguar dënimi. Dënimi duhet të paguhet nga koncesionari me rastin e pranimit. Në rast se koncesionari nuk e

paguan dënimin, atëherë Komuna ka të drejtë të ekzekutojë sigurimin e kontratës për të përmbushur detyrimin monetar të koncesionarit.

7.5 Operimi dhe mirëmbajtja e objektit

7.5.1 Operimi i objektit

Që nga përfundimi i punëve ndërtimore dhe për tërë kohëzgjatjen e kontratës, përveç nëse palët merren vesh ndryshe me shkrim, koncesionari ka për detyrë që, me shpenzime të veta, të operojë objektin dhe të ofroj shërbimet siç janë specifikuar në këtë kontratë dhe anekset relevante.

7.5.2 Pajisjet

Koncesionari ka për detyrë që, me shpenzime të veta, të blejë ose sigurojë në sasinë dhe cilësinë e duhur dhe të mirëmbajë në gjendje të rregullt pajisjet që nevojiten për operimin e objektit. Pajisjet e tilla duhet të plotësojnë të gjitha standardet teknike dhe mjedisore që kërkohen me ligj.

7.5.3 Emergjencat

Koncesionari pajtohet që çdo autoritet kompetent mund të ndërmerr të gjitha veprimet që i konsideron të nevojshme për të parandaluar apo për të reaguar në një rast emergjent, gjë që mund të përfshijë edhe mbylljen e objektit ose pezullimin e operimit të objektit. Koncesionari ka për detyrë që me mirëbesim dhe me kujdesin e duhur të ofrojë tërë mbështetjen që mund të kërkohet nga autoriteti kompetent.

7.5.4 Shërbimet publike dhe operacionale

7.5.4.1 Gjatë tërë kohëzgjatjes së kontratës, koncesionari ka për detyrë që, me shpenzime të veta, si dhe në pajtim me ligjin, të kujdeset që objekti të furnizohet vazhdimisht dhe në sasi të mjaftueshme me (i) ujë të pijshëm, (ii) energji elektrike, (iii) shërbime për grumbullimin e ujërave të zeza, dhe (iv) shërbime të telekomunikacionit.

7.5.6.2 Koncesionari ka për detyrë që, me shpenzime të veta, të sigurojë të gjitha shërbimet për parandalimin e zjarrit, zjarrfikjes, shërbime mjekësore dhe të shpëtimit si dhe shërbime të sigurimit të objektit.

7.5.5 Mjedisi

Koncesionari ka për detyrë që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme dhe që kërkohen me ligj për të mbrojtur mjedisin në vendndodhje dhe të kufizojë dëmet dhe pengesat që mund t'iu shkaktohen personave dhe pronave si pasojë e dëmtimit të mjedisit dhe pasojave të tjera të

dëmshme për mjedisin që rezultojnë nga operimi i objektit. Koncesionari nuk është përgjegjës ndaj personave të tretë për zhurmën që mund të shkaktohet nga operimi i objektit me kusht që zhurma është në kuadër të niveleve të lejuara me ligj.

7.5.6 Mirëmbajtja

7.5.6.1 Koncesionari ka për detyrë që, me shpenzime të veta, të mirëmbajë objektet (përveç objekteve fetare të parapara për ndërtim në hapësirat e caktuara) dhe hapësirat tjera të parapara me projekt në pajtim me doracakun për operim dhe mirëmbajtje si dhe në pajtim me ligjin dhe standardet përkatëse. Mirëmbajtja përfshinë riparimin ose zëvendësimin e çdo defekti ose dëmtimi të punëve ndërtimore të cilat shkaktohen ose shfaqen gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate. Koncesionari ka për detyrë të mbajë një regjistër ku shënohen të gjitha punët e mirëmbajtjes dhe të riparimit.

7.5.6.2 Nëse rast se koncesionari nuk i kryen në formën dhe standardin e kërkuar mirëmbajtjen, Komuna ka të drejtë të kryej punët e mirëmbajtjes. Koncesionari ka për detyrë që t'ia kompensojë Komunës të gjitha shpenzimet e arsyeshme dhe të dokumentuara në lidhje me këtë. Komuna ka të drejtë të ekzekutojë sigurimin e kontratës për të përmbushur detyrimin monetar të koncesionarit.

7.5.6.3 Koncesionari ka për detyrë të mbajë një regjistër të incidenteve ku shënohen data dhe koha e incidentit, përshkrimi i incidentit dhe veprimet që i ka ndërmarrë koncesionari në lidhje me incidentin.

7.6 Nënkontraktimi

7.6.1 Gjatë përmbushjes së detyrimeve të tij sipas kësaj kontrate, koncesionari ka të drejtë të përdorë dhe t'ia besojë personave të tretë në cilësinë e nën-kontraktorëve përmbushjen e një ose më shumë detyrimeve dhe shërbimeve sipas kësaj kontrate.

7.6.2 Koncesionari është tërësisht përgjegjës për veprimet, vonesën dhe pakujdesinë e nën-kontraktorëve të tij si dhe të përfaqësuesve dhe punëtorëve të nën-kontraktorëve sikur të ishin veprimet, vonesat dhe pakujdesia e vet koncesionarit.

7.6.3 Koncesionari ka për detyrë të mbajë një regjistër të të gjithë nënkontraktorëve si dhe nga një kopje të të gjitha kontratave të lidhura me nënkontraktorët. Koncesionari ka për detyrë t'ia lejojë Komunës qasjen e plotë në regjistër dhe në kopjet e kontratave për nevojat e mbikëqyrjes nga ana e Komunës të përmbushjes së kontratës nga koncesionari, mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve, të punëve ndërtimore si dhe operimin dhe mirëmbajtjen e objektit.

7.6.4 Përveç nëse Komuna pajtohet ndryshe me shkrim, koncesionari nuk ka të drejtë ta jep një të drejtë ose të lidhë ndonjë kontratë në lidhje me zbatimin e projektit, përfshirë objektet, vendndodhjen dhe shërbimet, e cila do të përfundojë pas datës së skadimit. Përveç nëse Komuna pajtohet ndryshe me shkrim, koncesionari ka për detyrë të sigurojë që secila kontratë të cilën e lidhë koncesionari në lidhje me projektin përcakton se në datën e shkëputjes ose skadimit të kësaj kontrate do të përfundojë ose do të kalojë kontrata te Komuna ose te personi i caktuar nga Komuna pa ndonjë obligim financiar të Komunës ose të personit të caktuar nga Komuna.

7.7 Raportimi

7.7.1 Kontributi aksionar dhe derdhja e kapitalit aksionar

Jo më vonë se 30 ditë nga çdo kontribut aksionar ose derdhje të kapitalit aksionar, koncesionari ka për detyrë t'ia paraqesë Komunës një certifikatë të përgatitur nga auditori i koncesionarit e cila tregon shumën dhe datën e kontributit aksionar ose derdhjes së kapitalit aksionar.

7.7.2 Raportet financiare dhe raportet e punës

Në ditën e 45-të të çdo tre-mujori gjatë tërë kohëzgjatjes së kontratës, koncesionari ka për detyrë t'ia paraqesë Komunës një raport të hollësishëm që përmban (a) rezultatet financiare të koncesionarit në lidhje me të gjitha punët operationale lidhur me shërbimet dhe objektin gjatë tre-mujorit të kaluar, ndërsa në rast se është raporti i parë i tillë, atëherë për periudhën prej datës efektive deri në përfundim të tre-mujorit të parë pas datës efektive, dhe (b) të dhëna lidhur me numrin e qiramarrëseve dhe klientëve të tjerë gjatë tre-mujorit të kaluar.

7.7.3 Ndërprerja dhe pezullimi

Koncesionari ka për detyrë që ta njoftojë Komunën menjëherë me shkrim në lidhje me çdo ndërprerje ose pezullim të shërbimeve, të punëve ndërtimore ose të operimit të objektit ose të ndonjë pjese të tij. Brenda 24 orëve të çdo ndërprerje ose pezullimi të shërbimeve, të punëve ndërtimore ose të operimit të objektit ose të pjesëve të tij, koncesionari ka për detyrë t'ia paraqesë Komunës një raport të hollësishëm lidhur me shkaqet e ndërprerjes, pezullimit ose të mbylljes. Komuna ka të drejtë të kërkojë nga koncesionari çdo informacion të cilin e konsideron të nevojshëm ose të arsyeshëm në lidhje me ndërprerjen ose pezullimin e shërbimeve, të punëve ndërtimore ose operimin e objektit ose të pjesëve të tij. Koncesionari ka për detyrë të përmbushë kërkesën e Komunës për informacione brenda 10 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës.

7.7.4 Pasqyrat vjetore financiare

Jo më vonë se në ditën e fundit të punës të muajit mars gjatë tërë kohëzgjatjes së kësaj kontrate, koncesionari ka për detyrë t'ia paraqesë Komunës një kopje të pasqyrës vjetore financiare të tij të audituar për vitin financiar të kaluar. Pasqyrat financiare duhet të jenë të përgatitura në pajtim me standardet e kontabilitetit të zbatueshme në Republikën e Kosovës dhe të paraqiten në Euro.

7.8 Mbatja e aksioneve

7.8.1 Për një periudhë kohore prej 3 viteve që nga data efektive, aksionarët kanë për detyrë të mbajnë në vazhdimësi të paktën 51% të numrit total të aksioneve me të drejtë vote të cilat i lëshon koncesionari kohë pas kohe.

7.8.2 Çdo bartje ose disponim me aksionet e lëshuara nga koncesionari si dhe krijimi i ndonjë detyrimi financiar të koncesionarit ose të një personi të asociuar me koncesionarin në dobi të aksionarëve i nënshtrohet miratimit me shkrim nga Komuna. Miratimi nuk nevojitet nëse aksionarët i lejnë aksionet peng ose i ngarkojnë aksionet me barrë tjetër ligjore për nevojat e financimit të projektit.

7.9 Distribucionet financiare

Koncesionari nuk ka të drejtë të bëjë asnjë pagesë, qoftë për nevoja të kredisë, aksioneve ose të tjera, në dobi të ndonjë aksionari ose të një personi të asociuar me aksionarin, përveç nëse (a) punët ndërtimore janë përfunduar, (b) sigurimi i përbushjes së kontratës është i plotfuqishëm ashtu siç kërkohet me këtë kontratë, dhe (c) koncesionari nuk është në vonesë me përbushjen e detyrimeve të tij sipas kësaj kontrate ose të ndonjë kontrate tjetër të cilën e ka lidhur koncesionari në lidhje me projektin.

7.10 Caktimi i auditorit

Koncesionari ka për detyrë që, me shpenzime të veta, të kontraktojë shërbimet e një kontabilisti të pavarur dhe të certifikuar si auditor, i cili është i pranueshëm për Komunën.

7.11 Qëllimi i vetëm

Deri në datën e shkëputjes ose të skadimit, cilado që ndodh e para, koncesionari nuk ka të drejtë të merret me asnjë aktivitet ose afarizëm, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Kosovës, përveç afarizmit dhe aktiviteteve të përcaktuara në këtë kontratë.

7.12 Pagesat

Koncesionari ka për detyrë të kryejë çdo pagesë për çdo detyrim ose zotim të tij që krijohet pas datës efektive në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kësaj kontrate. Komuna nuk mban asnjë përgjegjësi për detyrimet dhe zotimet e tilla të koncesionarit.

7.13 Inspektimet

Koncesionari ka për detyrë që gjatë orarit të rregullt të punës t'ia lejojë Komunës inspektimin e librave, planeve, shënimeve financiare dhe të dhënave dhe dokumenteve të tjera të cilat i takojnë koncesionarit ose mbahen nga ai lidhur me projektin.

7.14 Sigurimi për përmbushje

Koncesionari ka për detyrë të mbajë të plotfuqishme sigurimin për përmbushjen e kontratës në mënyrën e përcaktuar në nenin XI.

7.15 Emërtimi i objekteve

Komuna e rezervon të drejtën që të emërtojë objektet. Nëse kurdo gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate Komuna vendos të ndërrojë emërtimin e objektit, atëherë Komuna mund ta bëjë pa e konsultuar koncesionarin dhe pas pasur nevojë ta marrë pëlqimin ose miratimin e tij, mirëpo i bartë shpenzimet përkatëse.

7.16 Veprimtaritë e ndaluara

Gjatë kohëzgjatjes së kontratës, koncesionari nuk ka të drejtë të kryejë apo të lejojë aktivitetet të cilat nuk lejohen me ligje përkatëse në Kosovë, si dhe, ndër të tjera, kryerjen e këtyre veprimtarive:

7. 16.1 Kasino dhe lojëra fati,

7. 16.2 Prostitucion

7.17 Filialet

Koncesionari nuk ka të drejtë që pa pëlqimin paraprak dhe me shkrim të Komunës të themelojë ndonjë filial ose të bëjë ndonjë investim tjetër në formë aksionare ose kredie në ndonjë person

tjetër, ose të hyjë në një ndërmarrje të përbashkët ose marrëveshje tjetër afariste me ndonjë person tjetër, përveç nëse kjo lejohet shprehimisht me këtë kontratë.

NENI VIII – DETYRIMET E KOMUNËS

8.1. Komuna ka për detyrë, që me shpenzime të veta, të veprojë në pajtim me ligjin gjatë përmbushjes së detyrimeve të tij sipas kësaj kontrate.

8.2. Komuna zotohet se nuk do të ndërmerr asnjë veprim i cili do të ndërpresë ose do të pengojë kryerjen e shërbimeve, punët ndërtimore, operimin dhe mirëmbajtjen e objektit, si dhe arkëtimin e tarifës nga koncesionari, përveç nëse është përcaktuar ndryshe në këtë kontratë. Në rast të një ndërprerje të palejuar nga ana e Komunës, Komuna ka për detyrë t'ia kompensojë koncesionarit të gjitha shpenzimet të cilat i shkaktohen koncesionarit si pasojë e kësaj ndërprerje.

8.3. Gjatë tërë kohëzgjatjes së kësaj kontrate, Komuna nuk ka të drejtë që (a) të ndryshojë tarifën si dhe të caktojë ndonjë tarifë, taksë ose pagesë tjetër në lidhje me objektin dhe shërbimet, përveç nëse kërkohet ndryshe me ligj, ose (b) të ndërhyjë në mënyrë tjetër në arkëtimin e tarifës nga ana e koncesionarit, përveç nëse është përcaktuar ndryshe me kontratë.

8.4. Komuna ka për detyrë që (a) të sigurojë gjatë tërë kohëzgjatjes së kontratës posedimin e qetë në dobi të koncesionarit dhe (b) të sigurojë që pas datës së kontratës nuk do të disponojë me asnjë pjesë e vendndodhjes dhe nuk do të krijojë të drejta në lidhje me vendndodhjen ose pjesë të saj, përveç në mënyrën e përcaktuar në këtë kontratë.

8.5. Komuna ka për detyrë të sigurojë që të gjitha rrugët përmes të cilave mundësohet qasja në vendndodhje në datën e kësaj kontrate do të mirëmbahen në pajtim me ligjin dhe standardet përkatëse. Komuna zotohet se do të sigurojë që të gjitha rrugët përmes të cilave mundësohet qasja në objekt do të jenë të hapura dhe të shfrytëzueshme gjatë tërë kohëzgjatjes së kontratës, përveç në rast të një mbyllje të objektit ose pezullimit të punëve që mund të rezultojnë nga një emergjencë ose fuqi madhore.

8.6. Komuna ka për detyrë të sigurojë që nuk lejon kryerjen e aktiviteteve bazike të parapara me këtë kontratë, shërbimin e varrimit, në mënyrë të jashtëligjshme. Në rast të identifikimit të një situate të tillë, koncesionari kërkon nga Komuna të ndërmerr masa për ndalimin e këtyre aktiviteteve.

2. NENI IX – GARANCITË

9.1. Koncesionari garanton se që nga data e kontratës:

- (i) Kjo kontratë është nënshkruar nga koncesionari, se kontrata është juridikisht e vlefshme dhe obligative për të dhe se nuk nevojiten miratime, pëlqime apo regjistrime të tjera me qëllim që kjo kontratë të jetë plotësisht e vlefshme dhe në fuqi për të;
- (ii) Koncesionari i ka kapacitetet financiare për të zbatuar projektin dhe të përmbushë detyrimet e tij në pajtim me dispozitat e kësaj kontrate dhe ligjin;
- (iii) Koncesionari nuk është në dijeni se është duke u zhvilluar apo pritet të zhvillohet ndonjë procedurë dhe se nuk është ngritur dhe nuk pritet të ngritet ndonjë padi apo kërkesë kundër koncesionarit, e cila do të ndikonte, pa marrë parasysh mënyrën, në aftësinë e koncesionarit për të përmbushur detyrimet e tij sipas (a) kësaj kontrate ose (b) ndonjë prej kontratave tjera në të cilat do të hyjë koncesionari në lidhje me projektin;
- (iv) Aksionarët e koncesionarit janë: **1.Eurovia shpk , 2. Jehoha shpk, 3.Proing ;**
- (v) Punët ndërtimore kanë me qenë në pajtim me këtë kontratë, dokumentin e specifikimeve teknike, projektin ideor, projektin kryesor të ndërtimit si dhe me ligjin dhe standardet përkatëse; dhe
- (vi) Punët ndërtimore do të jenë pa defekte përmbajtësore të çfarëdo lloji dhe do të projektohen dhe ndërtohen në pajtim me standardet e ndërtimit dhe do të rezultojnë në objekt të përfunduar dhe të përdorshëm.

9.2. Komuna garanton se që nga data e kontratës:

- (i) Kjo kontratë është nënshkruar nga Komuna, se kontrata është juridikisht e vlefshme dhe obligative për të dhe se nuk nevojiten miratime, pëlqime apo regjistrime të tjera me qëllim që kjo kontratë të jetë plotësisht e vlefshme dhe në fuqi për të;
- (ii) Komuna nuk është në dijeni se është duke u zhvilluar ose pritet të zhvillohet ndonjë procedurë dhe se nuk është ngritur dhe nuk pritet të ngritet ndonjë padi apo kërkesë në lidhje me procedurën e prokurimit sipas së cilës koncesionari i është dhënë kjo kontratë;
- (iii) Komuna ka të drejtën e pronësisë, përkatësisht të shfrytëzimit, mbi vendndodhjen pa ndonjë barrë ligjore mbi të pa marrë parasysh llojin e barrës; dhe
- (iv) Komuna nuk ka disponuar me asnjë pjesë e vendndodhjes pas datës së dorëzimit të ofertës, përveç nëse është përcaktuar ndryshe me këtë kontratë.

NENI X – PËRGJEGJËSIA JURIDIKE DHE DËMSHPËRBLIMI

10.1 Përgjegjësia për palë të treta

10.1.1 Koncesionari ka për detyrë t'ia kompensojë Komunës çdo dëm që i shkaktohet asaj si pasojë e lëndimit ose vdekjes së një personi ose të cenimit të drejtave pronësore të një personi, me kusht që dëmi rezulton nga kryerja e shërbimeve, punët ndërtimore si dhe operimin e objektit. Koncesionari nuk është përgjegjës nëse dëmi është shkaktuar si pasojë e pakujdesisë së rëndë ose veprimit të qëllimshëm të Komunës ose si pasojë e fuqisë madhore, një emergjence ose të një ngjarje politike ose është shkaktuar nga një veprim i koncesionarit, i cili është kryer në bazë të kërkesës me shkrim të Komunës.

10.1.2 Komuna ka për detyrë t'ia kompensojë koncesionarit çdo dëm që i shkaktohet atij si pasojë e lëndimit ose vdekjes së një personi ose të cenimit të drejtave pronësore të një personi, me kusht që dëmi rezulton nga një veprim ose mosveprim i Komunës, përveç nëse dëmi është pasojë e pajkudesisë së rëndë ose veprimit të qëllimshëm të koncesionarit ose të një nën-kontraktuesi të koncesionarit, fuqisë madhore ose një emergjence.

10.2 Mospërmbushja e detyrimeve

10.2.1 Koncesionari ka për detyrë t'ia kompensojë Komunës çdo dëm që i shkaktohet asaj si pasojë e mospërmbushjes nga ana e koncesionarit të një garancie ose detyrimi të tij sipas kësaj kontrate, përveç nëse dëmi është pasojë e pakujdesisë së rëndë ose veprimit të qëllimshëm të Komunës, të një emergjence, ngjarjes politike ose fuqisë madhore.

10.2.2 Komuna ka për detyrë t'ia kompensojë koncesionarit çdo dëm që i shkaktohet atij si pasojë e mospërmbushjes nga ana e Komunës të një garancie ose detyrimi të saj sipas kësaj kontrate, përveç nëse dëmi është pasojë e pakujdesisë së rëndë ose veprimit të qëllimshëm të koncesionarit, të një emergjence ose fuqisë madhore.

10.3 Përgjegjësia për dëme mjedisore

10.3.1 Komuna është përgjegjëse për çdo dëm mjedisor i cili është identifikuar si i tillë në raportin e vlerësimit mjedisor dhe i cili që rezulton në përgjegjësi juridike sipas ligjit

10.3.2. Koncesionari është përgjegjës për çdo dëm mjedisor i cili është shkaktuar pas datës efektive dhe i cili rezulton në përgjegjësi juridike sipas ligjit.

10.4 Përgjegjësia për kërkesat e palëve të treta

Koncesionari ka për detyrë ta kompensojë Komunën për dëmin i cili i shkaktohet asaj si pasojë e një padie ose kërkesë (a) të një punëtori të punësuar në lidhje me objektin ose shërbimet që nga data efektive, të një personi i cili vepron në emër ose në vend të një punëtori të tillë, ose të një personi në bazë të një veprimi ose mosveprimi të një punëtori të tillë, ose (b) të një personi në lidhje me përgjegjësinë, detyrimin ose zotimin e koncesionarit ose të një kontraktori të koncesionarit, qoftë për shërbime të kryera ose mallra të pranuar nga personat e tillë në lidhje me objektin ose shërbimet, përveç nëse dëmi është shkaktuar ekskluzivisht nga një veprim ose mosveprim i Komunës.

10.5 Përgjegjësia për posedim të qetë

Komuna ka për detyrë ta kompensojë koncesionarin për dëmin i cili i shkaktohet atij si pasojë që Komuna nuk është në gjendje të sigurojë posedimin e qetë në lidhje me vendndodhjen ose pjesë të saj, përveç nëse dëmi shkaktohet nga një veprim apo mosveprim i koncesionarit ose nga një shkelje të kësaj kontrate nga ana e koncesionarit, përfshirë shkeljen e ligjit nga ana e koncesionarit.

10.6 Kufizimi i përgjegjësisë

10.6.1 Asnjë palë nuk ka të drejtë të kompensohet sipas kësaj kontrate më shumë se një herë për të njëjtin dëm.

10.6.2 Kompensimi që duhet të paguhet sipas këtij neni nuk e përfshinë fitimin e humbur.

10.6.3 Nga shuma e kompensimit që duhet të paguhet sipas këtij neni zbritet (a) vlera e ndonjë përfitimi tjetër, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të realizuar nga pala e dëmtuar si pasojë e dëmit në fjalë, dhe (b) shuma e pranuar nga pala e dëmtuar për dëmin përkatës në bazë të policës së sigurimit. Nëse këto shuma pranohen nga pala e dëmtuar pas pagesës së kompensimit për dëmin përkatës, atëherë pala e dëmtuar ka për detyrë t'ia paguaj palës kompensuese shumën e cila është e barabartë me (i) shumat e pranuar ose (ii) shumën e kompensimit që e ka paguar pala kompensuese, cilado që prej këtyre alternativave të jetë shuma më e vogël.

NENI XI – SIGURIMI I KONTRATËS

11.1 Sigurimi i kontratës

11.1.1 Koncesionari ka për detyrë që, me shpenzime të veta, të ofrojë dhe të mbajë një sigurim të kontratës përmes të cilit siguron pëmbushjen e detyrimeve të koncesionarit sipas kësaj kontrate për tërë kohëzgjatjen e kontratës. Sigurimi i kontratës duhet të jetë në formë të një garancie bankare në vlerë prej 10% (dhjetë përqind), e lëshuar në dobi të Komunës nga një bankë e licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës ose nga një bankë e huaj dhe e licencuar, e cila është e pranueshme për Komunën.

10.1.2 Me datën e nënshkrimit nga palët të certifikatës për përfundimin e punëve ndërtimore, sigurimi i kontratës zvogëlohet në një shumë që është e barasvlershme me 75% të vlerës së saj fillestare.

10.2 Ekzekutimi i sigurimit të kontratës

10.2.1 Komuna ka të drejtë të ekzekutojë sigurimin e kontratës për

- (i) Kompensimin e dëmit të shkaktuar nga koncesionari te Komuna si pasojë e shkeljes së koncesionarit të detyrimeve dhe garancive të tij sipas kësaj kontrate;
- (ii) Kompensimin e dëmit të shkaktuar nga koncesionari si pasojë e moskryerjes së shërbimeve nga koncesionari në pajtim me këtë kontratë;
- (iii) Kompensimin e shpenzimeve të arsyeshme të cilat i shkaktohen Komunës si pasojë e korigjimit të defekteve të punëve ndërtimore;
- (iv) Kompensimin e dëmit dhe shpenzimeve, përfshirë edhe shpenzimet lidhur me ritenderimin e koncesionit, të cilat i shkaktohen Komunës me rastin e shképutjes së kësaj kontrate për shkak të fajit të koncesionarit;
- (v) Kompensimin e dëmit dhe shpenzimeve të cilat i shkaktohen Komunës për shkak se Komuna e ushtron të drejtën e saj për ndërhyrje sipas kësaj kontrate;
- (vi) Përbushjen e pagesës së dënimeve që duhet të paguhet nga koncesionari në pajtim me këtë kontratë;
- (vii) Përbushjen e ndonjë detyrimi tjetër monetar të koncesionarit në dobi të Komunës sipas kësaj kontrate.

10.2.2 Komuna ka për detyrë ta njoftojë koncesionarin me shkrim për çdo ekzekutim të sigurimit të kontratës si dhe të arsyes të ekzekutimit.

10.2.3 Në rast të ekzekutimit të sigurimit të kontratës nga Komuna, koncesionari ka për detyrë që brenda 15 ditëve nga dita e ekzekutimit të sigurimit të kontratës të sigurojë që sigurimi i kontratës të ketë vlerën që e ka pasur në kohën kur është ekzekutuar sigurimi i kontratës dhe siç kërkohet me këtë kontratë.

10.2.4 Ekzekutimi i sigurimit të kontratës nga Komuna nuk i përjashton mjetet tjera juridike të cilët i takojnë Komunës sipas kësaj kontrate.

NENI XII – POLICAT E SIGURIMIT

12.1 Policat e sigurimit

Koncesionari ka për detyrë që, me shpenzime të veta, të blejë dhe të mbajë të vlefshme për tërë kohëzgjatjen e kontratës policat vijuese të sigurimit të lëshuara nga ndërmarrje të sigurimit të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës ose të licencuara jashtë Kosovës dhe e pranueshme nga Komuna:

- (i) Sigurim të pronës të formës së gjerë që mbulon objektin;
- (ii) Sigurim të plotë të ndërtimit;

- (iii) Sigurim të përgjegjësive për palë të treta për kryerjen e shërbimeve, operimin e objektit si dhe për ndërtimin e objektit, përfshirë lëndimet personale dhe dëmtimin e pronës në raport me palë të treta;

12.2 Komuna si përfituese

Në të gjitha policat e sigurimit që kërkohen sipas kësaj kontrate Komuna duhet të ceket si person tjetër i siguruar.

12.3 Mungesa e përgjegjësive së Komunës për mos-sigurim

Komuna nuk bartë asnjë rrezik dhe përgjegjësi nëse koncesionari nuk blen ose nuk i mban të vlefshme policat e sigurimit që kërkohen sipas kësaj kontrate si dhe nuk ka ndonjë detyrim që t'ia kompensojë koncesionarit ndonjë dëm të pasiguar.

12.4 Ndryshime

Koncesionari ka për detyrë që ta njoftojë Komunën me shkrim për çdo ndryshim në policat e sigurimit ose kufizimet e policave të sigurimit të cilat i ka siguruar koncesionari sipas kësaj kontrate. Njoftimi duhet t'i dorëzohet Komunës brenda 30 ditëve nga dita që ka ndodhur ndryshimi.

12.5 Përrjashtimi

Nëse gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate koncesionarit i pamundësohet blerja ose mbajtja e ndonjë police të sigurimit sipas kësaj kontrate nën kushte të arsyeshme afariste, atëherë koncesionari mund të kërkojë me shkrim nga Komuna që ajo ta përjashtojë koncesionarin nga detyrimi në fjalë. Kërkesa duhet të paraqesë me hollësi arsyen e kërkesës, të përmbajë të gjitha dëshmitë si dhe të cekë kushtet e përjashtimit.

NENI XIII – FUQIA MADHORE

13.1 Përkufizimi i fuqisë madhore

Fuqi madhore nënkupton çdo ngjarje e cila është jashtë kontrollit të arsyeshëm të Komunës ose të koncesionarit dhe e cila nuk ka mundur të parashikohet në datën e kontratës, duke përfshirë luftë të shpallur apo të pashpallur, revolucion, trazira, kryengritje, greva, me përjashtim të grevave të punëtorëve të koncesionarit ose të ndonjë nën-kontraktori të tij, përveç nëse një grevë e tillë është

pjesë e një greve të përgjithshme në Republikën e Kosovës ose e një greve të përgjithshme në sektorin përkatës në Republikën e Kosovës, invazion, konflikt i armatosur, veprime armiqësore të një armiku të huaj, bllokada, embargo, akte terrorizmi, sabotazha, rrezatime radioaktive, kontaminime biologjike ose kimike, eksplozime, zjarr, epidemi, vërshime, tërmete, rufe, si dhe çdo fatkeqësi tjetër natyrore ose ngjarje e ngjashme.

13.2 Raportimi i rastit të fuqisë madhore

13.2.1 Me rastin e një fuqie madhore, por jo më vonë se 24 orë pasi që pala e prekur nga rasti i fuqisë madhore ("pala e prekur") është vënë në dijeni ose është dashur të ketë dijeni për rastin e fuqisë madhore, pala e prekur ka për detyrë t'ia raportojë palës tjetër rastin e fuqisë madhore. Raporti duhet të përmbajë të paktën këto të dhëna:

- (i) Natyrën dhe përmasat e rastit të fuqisë madhore së bashku me dëshmitë për këtë;
- (ii) Kohëzgjatje e prituri dhe efektin e mundshëm që rasti i fuqisë madhore e ka ose mund të ketë lidhur me aftësinë e palës së prekur për të përmbushur detyrimet e saj sipas kësaj kontrate;
- (iii) Masat të cilat pala e prekur i ndërmerr ose propozon të ndërmerren për të zbutur ndikimin e rastit të fuqisë madhore.

13.2.2 Pala e prekur nuk ka të drejtë të përdorë mjetet juridike sipas kësaj kontrate lidhur me fuqinë madhore nëse nuk e ka raportuar rastin e fuqisë madhore te pala tjetër në pajtim me këtë kontratë.

13.3 Pasojat e rastit të fuqisë madhore

13.3.1 Me rastin e fuqisë madhore, të gjitha afatet që duhet të respektohen sipas kësaj kontrate dhe të cilat nuk mund të përmbushen për shkak të rastit të fuqisë madhore vazhdojnë për një periudhë kohore e cila është e barabartë me kohëzgjatjen e rastit të fuqisë madhore.

13.3.2 Nëse rasti i fuqisë madhore pamundëson tërësisht ose pjesërisht përmbushjen e detyrimeve të cilësdo palë sipas kësaj kontrate, atëherë pala e prekur nuk është përgjegjëse për mospërmbushjen e detyrimit, ndërsa pala tjetër nuk ka të drejtë të shpëpusë këtë kontratë, përveç nëse është përcaktuar ndryshe në këtë kontratë.

13.3.3 Pala e prekur ka për detyrë të ndërmerr të gjitha veprimet komercialisht të arsyeshme për të vazhduar me përmbushjen e detyrimeve të saj sipas kësaj kontrate dhe të minimizojë pasojat negative të rastit të fuqisë madhore.

13.4 Kompensimi

Asnjëra palë nuk ka të drejtë të kërkojë kompensim ose pagesë tjetër nga pala tjetër për shkak të rastit të fuqisë madhore ose shkëputjes së kontratës për shkak të fuqisë madhore.

NENI XIV – NGJARJE POLITIKE

14.1 Ngjarje politike

Ngjarja politike nënkupton (i) çdo formë të shpronësimit të pronës nga një autoritet publik, (ii) revokimin ose tërheqjen e ndonjë leje, përveç nëse kjo bëhet në pajtim me dispozitat e lejes, dispozitat e një kontrate përkatëse ose në pajtim me ligjin, (iii) çdo caktim ose ndryshim të tarifave, taksave ose ngarkesave tjera financiare në lidhje me shërbimet e parkingut, përveç nëse kjo bëhet në pajtim me këtë kontratë ose me pëlqimin paraprak të koncesionarit, dhe (iv) nëse Komuna ose ndonjë autoritet tjetër kompetent nuk e lëshon, vazhdon ose pranon një leje, përveç nëse kjo ndodhë në pajtim me ligjin, ose në pajtim me dispozitat e lejes ose të një kontrate përkatëse, me kusht që një ngjarje e tillë ndikon materialisht dhe negativisht në pozitën juridike, ekonomike ose afariste të koncesionarit ose të projektit në krahasim me pozitën që e ka pasur në datën e kontratës.

14.2 Njoftimi

Në rast se ndodhë një ngjarje politike, koncesionari ka për detyrë ta njoftojë Komunën me shkrim brenda 30 ditëve nga ngjarja politike ose që nga dita që koncesionari vihet në dijeni për këtë ngjarje politike. Njoftimi duhet të përmbajë të dhënat e arsyeshme në lidhje me ngjarjen politike për atë që janë të njohura për koncesionarin dhe pasojat e mundshme juridike, ekonomike dhe afariste për koncesionarin si dhe të përmbajë një kërkesë për evitimin e ngjarjes politike.

14.3 Shfajësimi për mospërbushje

Në rast se një ngjarje politike vonon ose në mënyrë tjetër pengon përmbushjen e tërësishme ose të pjesshme të një detyrimi të koncesionarit sipas kësaj kontrate, atëherë koncesionari nuk është përgjegjës për ndonjë mospërbushje të tillë, ndërsa Komuna nuk ka të drejtë ta shkëpusë këtë kontratë përveç kur kjo lejohet shprehimisht me këtë kontratë. Pa marrë parasysh ngjarjen politike, koncesionari ka për detyrë të ndërmerr të gjitha masat e mundshme që të vazhdojë me përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kësaj kontrate dhe të minimizojë pasojat negative të ngjarjes politike.

NENI XV – SHKËPUTJA E KONTRATËS

15.1 Shkëputja e kontratës për shkak të fuqisë madhore ose të ngjarjes politike

15.1.1 Nëse ndodhë një rast i fuqisë madhore ose një ngjarje politike, e cila vazhdon në mënyrë të pandërprerë për një periudhë kohore prej të paktën 90 ditëve dhe e cila ndalon përmbushjen e tërësishme ose të pjesshme të detyrimeve të cilësdo palë sipas kësaj kontrate, atëherë secila palë ka të drejtë të shkëpusë këtë kontratë.

15.1.2 Pala përkatëse ka për detyrë të njoftojë palën tjetër me shkrim në lidhje me vendimin e saj për ta shkëputur kontratën. Shkëputja e kontratës hyn në fuqi 10 ditë pune pas dorëzimit të njoftimit të pala tjetër.

15.2 Shkëputja e kontratës nga Komuna

15.2.1 Komuna ka të drejtë të shkëpusë këtë kontratë në rastet vijuese:

- (i) Koncesionari nuk i kryen shërbimet gjatë një periudhe të pandërprerë kohore prej 48 orësh, përveç nëse moskryerja e këtyre shërbimeve lejohet ose kërkohet sipas kësaj kontrate ose nëse lejohet me shkrim nga Komuna;
- (ii) Koncesionari nuk i plotëson indikatorët kryesor të performancës për një periudhë të pandërprerë kohore prej të paktën 30 ditëve, përveç nëse kjo është lejuar me shkrim nga Komuna;
- (iii) Koncesionari nuk kryen punë ndërtimore në vendndodhje në pajtim me planin e punëve ndërtimore për një periudhë të vazhdueshme kohore prej 30 ditëve të punës, përveç nëse moskryerja e këtyre punëve lejohet ose kërkohet sipas kësaj kontrate ose nëse lejohet me shkrim nga Komuna;
- (iv) Koncesionari nuk i përfunduar punët ndërtimore me afat ose në pajtim me standardet që kërkohen me këtë kontratë, përveç nëse lejohet ndryshe me shkrim nga Komuna;
- (v) Koncesionari nuk përmbushë ose është në vonesë me përmbushjen e detyrimeve të tij sipas ndonjë kontrate financimi në lidhje me këtë projekt;
- (vi) Koncesionari nuk e zgjedhë në favor të tij çfarëdo procedurë në lidhje me falimentimin, shpërbërjen ose likuidimin e tij brenda 30 ditëve që nga fillimi i procedurës në fjalë;
- (vii) Koncesionari merr një urdhër të gjykatës përmes së cilës vendoset në procedurë të falimentimit ose të likuidimit;
- (viii) Koncesionari nuk përmbushë ose është në vonesë me përmbushjen e detyrimeve dhe garancive të tij sipas kësaj kontrate ose të ndonjë kontrate të tjetër të cilën e ka lidhur në lidhje me këtë projekt, dhe mospërmbushja ose vonesa ka vazhduar për një periudhë kohore prej 60 ditëve nga dita kur Komuna e ka njoftuar koncesionarin për mospërmbushjen ose vonesën në fjalë.

15.2.2 Komuna ka për detyrë të shkëpusë këtë kontratë përmes dorëzimit të një njoftimi me shkrim te koncesionari. Shkëputja e kontratës hyn në fuqi 10 ditë pune pas dorëzimit të njoftimit te koncesionari.

15.3 Shkëputja e kontratës nga koncesionari

15.3.1 Koncesionari ka të drejtë të shkëpusë këtë kontratë nëse Komuna nuk e përmbushë ose është në vonesë me përmbushjen e ndonjë detyrimi ose garancie të saj sipas kësaj kontrate, dhe mospërmbushja ose vonesa ka vazhduar për një periudhë kohore prej 60 ditëve nga dita kur koncesionari e ka njoftuar Komunën për mospërmbushjen ose vonesën në fjalë.

15.3.2 Koncesionari ka për detyrë të shkëpusë këtë kontratë përmes dorëzimit të një njoftimi me shkrim te Komuna. Shkëputja e kontratës hyn në fuqi 10 ditë pune pas dorëzimit të njoftimit te Komuna.

15.4 Pasoja e shkëputjes së kontratës

Në datën e shkëputjes:

- (i) Kjo kontratë pushon të jetë e vlefshme dhe të prodhojë efekte juridike, përveç dispozitave vijuese që vazhdojnë të vlejné edhe pas shkëputjes së kontratës: nenet X.1, X.3, XI, XV, XVI, XX, XXI, XXII, XXIII;
- (ii) Koncesioni dhe të drejtat e koncesionarit shuhet;
- (iii) Koncesionari ka për detyrë që menjëherë të lirojë vendndodhjen si dhe objektin dhe t'ia kalojë Komunës, me shpenzime dhe në rrezik të koncesionarit, posedimin dhe pronësinë mbi vendndodhjen, objektin, makineritë, instalimet, pajisjet dhe të gjithë pronësinë tjetër të luajtshme dhe intelektuale që është në posedim të koncesionarit dhe që nevojitet për operimin e objektit, si dhe të gjitha dokumentet që janë në pronësi ose në posedim të koncesionarit dhe që kanë të bëjnë specifikisht me punët ndërtimore dhe operimin e objektit;
- (iv) Komuna ka të drejtë që (i) të hyjë në objekt dhe menjëherë të merr përsipër kontrollin operacional mbi objektin dhe vendndodhjen, dhe (ii) të merr në posedim të gjitha makineritë, instalimet, pajisjet si dhe pronësinë tjetër të luajtshme dhe intelektuale të koncesionarit që nevojitet për operimin e objektit;
- (v) Komuna ka të drejtë të ekzekutojë sigurimin e përmbushjes në mënyrën e përcaktuar në këtë kontratë.

4.2 Nëse koncesionari nuk ia kalon Komunës posedimin mbi vendndodhjen dhe objektin në pajtim me këtë nen, atëherë koncesionari ka për detyrë t'ia kompensojë Komunës të gjithë démin që i shkaktohet asaj si pasojë e kësaj. Komuna ka të drejtë të ekzekutojë sigurimin e përmbushjes për të përmbushur detyrimin e koncesionarit për të paguar kompensimin e sipërcekur.

15.5 Kompensimi në rast të shkëputjes së kontratës

15.5.1 Në rast të shkëputjes së kësaj kontrate nga Komuna sipas pikës 2 të këtij neni, përveç rastit të shkëputjes për shkak të fuqisë madhore dhe të ngjarjes politike,

- (i) Komuna nuk është përgjegjëse për kompensimin e ndonjë dëmi që i shkaktohet koncesionarit si pasojë e shkëputjes së kontratës si dhe nuk është përgjegjëse për të kompensuar apo për të paguar në ndonjë formë tjetër detyrimet financiare të koncesionarit ndaj personave të tretë;
- (ii) Koncesionari ka për detyrë t'ia kompensojë Komunës të gjithë dëmin që i shkaktohet asaj si pasojë e shkëputjes së kontratës.

15.5.2 Si përjashtim nga dispozita 5.1 (i) e këtij neni, në rast se koncesionari i ka përfunduar të gjitha punët ndërtimore në pajtim me këtë kontratë, Komuna ka për detyrë t'ia kompensojë koncesionarit prej dy alternativave vijuese atë që rezulton në shumën më të vogël: (i) shpenzimet e arsyeshme dhe të dokumentuara të punëve ndërtimore, pa përfshirë shpenzimet e tejkaluara, dhe duke ia zbritur kësaj shume amortizimin e objektit në bazë të metodës së amortizimit linear si dhe dëmin që i është shkaktuar Komunës si pasojë e shkëputjes së kontratës, ose (ii) shumën e mbetur të kryegjësë (principalit) të ndonjë kontrate financimi për ndërtimin e objektit, duke përjashtuar të gjitha taksat, dënimet ose pagesat tjera që koncesionari duhet t'i paguaj në lidhje me kontratën e financimit.

15.5.3 Në rast të shkëputjes së kësaj kontrate nga koncesionari sipas pikës 3 të këtij neni, përveç në rastin e shkëputjes së kontratës për shkak të fuqisë madhore, si dhe në rast të shkëputjes së kësaj kontrate nga cilado palë për shkak të ngjarjes politike,

- (i) Komuna ka për detyrë t'ia kompensojë koncesionarit dëmin e shkaktuar si pasojë e shkëputjes së kontratës;
- (ii) Koncesionari nuk është përgjegjës për t'ia kompensuar Komunës dëmin e shkaktuar si pasojë e shkëputjes së kontratës.

NENI XVI – DORËZIMI I OBJEKTIT

16.1 Plani i dorëzimit

180 ditë para skadimit të kësaj kontrate (periudha e dorëzimit), koncesionari ka për detyrë t'ia paraqesë Komunës një plan të dorëzimit për miratim, i cili duhet të përmbajë (i) procedurën për dorëzimin prej koncesionarit te Komuna të vendndodhjes, objektit dhe të gjithë pronës së luajtshme dhe intelektuale të ndërlidhur me të, (ii) një inventar të hollësishëm të të gjithë pronës së luajtshme

dhe intelektuale e cila duhet të bartet prej koncesionarit te Komuna dhe (iii) caktimin e datës së dorëzimit, e cila nuk mund të tejkalojë datën e skadimit të kësaj kontrate.

16.2 Shpenzimet e dorëzimit

Secila palë i bartë shpenzimet e veta lidhur me kalimin e vendndodhjes, objektit dhe pronësisë së luajtshme dhe intelektuale përkatëse prej koncesionarit te Komuna në pajtim me këtë nen.

16.3 Kushtet e dorëzimit

Koncesionari ka për detyrë të sigurojë, me shpenzime të veta, që në datën e dorëzimit vendndodhja, objekti si dhe të gjitha pronat e luajtshme dhe intelektuale përkatëse janë në pajtim me standardet dhe kushtet e përcaktuara në këtë kontratë. Vendndodhja, objekti dhe çdo pronë e luajtshme dhe intelektuale përkatëse duhet t'i bartet Komunës pa asnjë kërkesë, të drejtë apo barrë ligjore të ndonjë pale të tretë.

16.4 Inspektimi i dorëzimit

Në datën e dorëzimit, Komuna dhe koncesionari kanë për detyrë që së bashku të inspektojnë vendndodhjen dhe objektin për të vërtetuar nëse vendndodhja dhe objekti plotësojnë standardet dhe kushtet e përcaktuara në këtë kontratë. Nëse të dyja palët pajtohen se standardet dhe kushtet janë plotësuar, atëherë Komuna ia dorëzon koncesionarit një certifikatë të dorëzimit përmes së cilës vërtetohet se ka përfunduar dorëzimi. Nëse Komuna paraqet që standardet dhe kushtet në fjalë nuk janë plotësuar, atëherë Komuna ka për detyrë që brenda 5 ditëve të punës nga dita e inspektimit t'ia dorëzojë koncesionarit një raport me shkrim në të cilin ceken të gjitha defektet e identifikuar gjatë inspektimit. Koncesionari ka afat prej 60 ditëve pas pranimit të raportit që, me shpenzime të veta, të përmirësojë defektet e identifikuar nga Komuna. Gjatë kohës që është duke i kryer punët dhe riparimet e nevojshme, koncesionari ka për detyrë që, me shpenzime të veta, të vazhdojë me kryerjen e shërbimeve dhe të operojë dhe të mirëmbajë objektin. Nëse koncesionari nuk i kryen përmirësimet brenda afatit të caktuar, Komuna ka të drejtë që të ndërmerr të gjitha punët dhe riparimet dhe koncesionari ka për detyrë t'ia kompensojë Komunës të gjitha shpenzimet e arsyeshme dhe të dokumentuara të cilat i shkaktohen si pasojë e këtyre punëve dhe riparimeve. Komuna ka të drejtë të ekzekutojë sigurimin e kontratës për të përmbushur detyrimin e koncesionarit në lidhje me kompensimin e Komunës për shpenzimet e shkaktuara.

16.5 Shkëputja e kontratave

Në datën e dorëzimit ose më herët, koncesionari ka për detyrë që të shkëpusë të gjitha kontratat të cilat i ka lidhur me palë të treta në lidhje me vendndodhjen, objektin dhe pronësinë tjetër të luajtshme dhe intelektuale përkatëse, përveç nëse Komuna pranon të marrë përsipër një ose më shumë kontrata të tilla.

16.6 Shuarja e koncesionit

Që nga data e dorëzimit, koncesioni dhe të drejtat e koncesionarit sipas kësaj kontrate shuhet, dhe koncesionari ka për detyrë të lirojë vendndodhjen dhe objektin si dhe të përmbyllë çdo operim dhe shërbim në vendndodhje dhe në objekt.

NENI XVII – CEDIMI (BARTJA) E KONTRATËS

17.1 Cedimi

17.1.1 Koncesionari nuk ka të drejtë që, pa pëlqimin e Komunës, t'ia bartë tjetërkujt (i) këtë kontratë ose ndonjë kontratë tjetër të lidhur nga koncesionari në lidhje me këtë projekt, dhe (ii) asnjë të drejtë ose detyrim sipas kësaj kontrate ose ndonjë kontrate tjetër të cilën e ka lidhur koncesionari në lidhje me këtë projekt.

17.1.2 Koncesionari nuk ka të drejtë që, pa pëlqimin e koncesionarit, t'ia bartë tjetërkujt këtë kontratë ose ndonjë të drejtë ose ndonjë detyrim sipas kësaj kontrate.

17.2 Krijimi i mjeteve siguroese

Për nevojat e financimit të projektit, koncesionari ka të drejtë të cedojë ose të lë si siguri të drejtat e tija sipas kësaj kontrate ose të ndonjë kontrate tjetër të cilën e ka lidhur koncesionari, përfshirë pronën e tij të luajtshme dhe intelektuale si dhe tarifatat dhe qiranë si dhe cilindo send tjetër që është në pronësinë e tij Koncesionari nuk ka të drejtë të cedojë ose të lë si siguri vendndodhjen, objektin si dhe çdo pronë tjetër të paluajtshme të Komunës.

NENI XVIII – ZËVENDËSIMI I KONCESIONARIT

18.1. Komuna dhe koncesionari kanë të drejtë që së bashku të lidhin një kontratë direkte me kredithënësit e koncesionarit. Kontrata direkte përcakton procedurën për zëvendësimin e

koncesionarit nga kredidhënësit e koncesionarit në rast se koncesionari nuk përmbushë detyrimet e tij sipas kësaj kontrate ose të kontratës së financimit.

18.2. Kontrata direkte duhet të sigurojë që personi i caktuar nga kredidhënësit e koncesionarit për zëvendësimin e koncesionarit i plotësojnë kushtet vijuese:

- (i) Personi është i themeluar dhe i regjistruar në mënyrë të ligjshme dhe të plotfuqishme si shoqëri tregtare sipas ligjeve të Republikës së Kosovës si dhe e ka aftësinë të hyjë në marrëdhëniet kontraktore që mund të kërkohen për nevojat e zëvendësimit;
- (ii) Personi i ka kualifikimet e mjaftueshme financiare dhe teknike për të përmbushur dhe marrë përsipër detyrimet e koncesionarit sipas kësaj kontrate;
- (iii) Personi e ka aftësinë për t'i paguar detyrimet financiare të cilat koncesionari ka për detyrë t'ia paguajë Komunës para ose gjatë kohës së zëvendësimit; dhe
- (iv) Personi i plotëson të gjitha kushtet dhe kualifikimet ligjore të përcaktuara me ligj.

NENI XIX – E DREJTA E KOMUNËS PËR TË NDËRHYRË

19.1 E drejta e ndërhyrjes

Nëse Komuna ka arsye të mendojë se duhet të ndërmerr masa në lidhje me kryerjen e shërbimeve për shkak se koncesionari nuk i përmbushë detyrimet e tij sipas kësaj kontrate ose për shkak të një rreziku serioz dhe urgjent i cili i kanoset shëndetit ose sigurisë së personave, pronës, mjedisit, sigurisë kombëtare, ose për të përmbushur ndonjë detyrim ligjor, atëherë Komuna ka të drejtë të merr masa në pajtim me dispozitat e këtij neni.

19.2 Njoftimi

19.2.1 Nëse Komuna vendos për të marrë masa në pajtim me këtë nen, atëherë ajo ka për detyrë që menjëherë ta njoftojë koncesionarin me shkrim lidhur me:

- (i) Masat që do të ndërmerr;
- (ii) Arsyet për marrjen e këtyre masave;
- (iii) Datën kur Komuna do të fillojë me marrjen e këtyre masave;
- (iv) Periudha kohore e cila sipas Komunës do të nevojitet për marrjen e këtyre masave, periudhë kjo që duhet me qenë e caktuar ("kohëzgjatja e ndërhyrjes"); dhe
- (v) Ndikimin e mundshëm të këtyre masave në koncesionarin dhe detyrimet e tij sipas kësaj kontrate gjatë kohëzgjatjes së ndërhyrjes, për aq sa një parashikim i tillë është i mundshëm.

19.2.2 Pas dorëzimit të njoftimit në fjalë, Komuna ka të drejtë të ndërmerr masat për të cilat e ka njoftuar koncesionarin, si dhe masat tjera të ndërlydhura që me arsye janë të nevojshme. Koncesionari ka për detyrë të mbështes Komunën në marrjen e këtyre masave.

19.3 Pasojat e ndërhyrjes

19.3.1 Nëse masat që i ndërmerr Komuna ia pamundësojnë koncesionarit përmbushjen e ndonjë detyrimi sipas kësaj kontrate dhe Komuna nuk i ndërmerr masat për shkak se koncesionari nuk i ka përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, atëherë

- (i) Koncesionari lirohet nga përgjegjësia për të përmbushur detyrimin në fjalë gjatë kohëzgjatjes së ndërhyrjes; dhe
- (ii) Komuna ka për detyrë t'ia kompensojë koncesionarit dëmin që i shkaktohet si pasojë e ndërhyrjes.

19.3.2 Nëse Komuna i merr masat si pasojë e mospërmbushjes së koncesionarit të detyrimeve të tij sipas kontratës, atëherë

- (i) Koncesionari lirohet nga përgjegjësia për të përmbushur detyrimet në fjalë gjatë kohëzgjatjes së ndërhyrjes;
- (ii) Koncesionari ka për detyrë t'ia kompensojë Komunës dëmin dhe të gjitha shpenzimet që i shkaktohen asaj si pasojë e ndërhyrjes; dhe
- (iii) Komuna nuk ka përgjegjësi për t'ia kompensuar koncesionarit dëmin e shkaktuar si pasojë të ndërhyrjes.

NENI XX – ZGJIDHJA E KONTESTEVE

20.1 Zgjidhja me marrëveshje

Palët kanë për detyrë të bëjnë përpjekjet maksimale për të zgjidhur me marrëveshje çfarëdo kontesti që mund të rezultojë në lidhje me këtë kontratë. Marrëveshja e tillë është e plotfuqishme nëse bëhet me shkrim dhe nënshkruhet në emër të palëve nga përfaqësues të autorizuar.

20.2 Arbitrazhi

Nëse një kontest nuk mund të zgjidhet me marrëveshje brenda 30 ditëve nga dita kur njëra palë pranon nga pala tjetër kërkesën me shkrim për zgjidhje të kontestit me marrëveshje, atëherë secila palë ka të drejtë të fillojë procedurën e arbitrazhit para një gjykate të arbitrazhit të përbërë nga 3 arbitra dhe të themeluar sipas ligjit të Kosovës që është në fuqi për arbitrazhin. Gjykata e arbitrazhit zbaton të drejtën e Kosovës pa i marrë parasysh parimet dhe rregullat e së drejtës ndërkombëtare private. Procedura e arbitrazhit zhvillohet në Republikën e Kosovës. Vendimi i gjykatës së arbitrazhit është juridikisht i detyrueshëm për të dyja palët dhe i ekzekutueshëm sipas ligjit në fuqi.

NENI XXI – E DREJTA E ZBATUESHME

Kjo kontratë si dhe të drejtat dhe detyrimet e palëve sipas kësaj kontrate rregullohen dhe interpretohen në pajtim me ligjet e Republikës së Kosovës, pa i marrë parasysh parimet dhe rregullat e së drejtës ndërkombëtare private.

NENI XXII – HEQJA DORË NGA IMUNITETI

Nëse një palë ka të drejtë që të invokojë për vete ose për të ardhurat, mjetet ose pronën e saj imunitet nga procedura gjyqësore ose e arbitrazhit si dhe ekzekutimin e një aktgjykimi ose vendimi tjetër, pala përkatëse në mënyrë të parevokueshme dhe të pakushtëzuar heq dorë nga invokimi dhe pranimi i imunitetit të tillë.

NENI XXIII – DISPOZITA TË NDRYSHME

23.1 Primati i kësaj kontrate

Me këtë kontratë rregullohen të gjitha aspektet dhe marrëdhëniet kontraktore në lidhje me projektin. Secila palë ka për detyrë të sigurojë që pas nënshkrimit të kësaj kontrate nënshkrimi nga ana e saj e ndonjë kontrate tjetër në lidhje me projektin nuk ka për pasojë që pala në fjalë të shkelë detyrimet e saj sipas kësaj kontrate.

23.2 Tërësia e kontratës

Kjo kontratë paraqet tërë marrëveshjen e arritur midis palëve lidhur me projektin dhe që nga data efektive ka epërsi ndaj të gjitha kontratave dhe aranzhimeve të mëparshme midis palëve në lidhje me materien që e rregullon kjo kontratë.

23.3 Konfidencialiteti

23.3.1 Secila palë ka për detyrë të mbajë konfidenciale dhe të mos bëjë publike pa pëlqimin paraprak dhe me shkrim të palës tjetër të gjitha vizatimet, të dhënat, librat, raportet, dokumentet dhe informacionet që nuk janë publike, pa marrë parasysh nëse këto janë të natyrës teknike, afariste ose financiare, dhe të cilat i pranon nga pala tjetër ose në emër të saj në lidhje me projektin, përveç

- (i) në rast të koncesionarit, kur publikimi kërkohet për nevojat e arsyeshme të këshilltarëve, personave të asociuar, siguruesve, kontraktorëve ose kredhënësve të tij lidhur me financimin e projektit ose për përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kësaj kontrate; ose
- (ii) në rast të Komunës, kur publikimi kërkohet për nevojat e arsyeshme të zyrtarëve, këshilltarëve, siguruesve dhe përfaqësuesve të saj si dhe për nevojat e arsyeshme të ndonjë autoriteti publik të Kosovës lidhur me përmbushjen e detyrimeve të saj sipas kësaj kontrate apo kur publikimi është në interes publik apo kërkohet me ligj.

23.3.2 Dispozitat e këtij neni nuk e kufizojnë të drejtën e Komunës për të përdorur dokumentet dhe informacionet në fjalë kur kontrata të përfundojë sipas dispozitave të kësaj kontrate. Secila palë është përgjegjëse për mosrespektimin e konfidencialitetit siç kërkohet në dispozitat e këtij neni si

dhe për publikimin a paautorizuar të informacioneve konfidenciale nga personat e asociuar, këshilltarët ose përfaqësuesit e saj.

23.4 Ndryshimi i kontratës

Të gjitha plotësimet dhe ndryshimet në lidhje me këtë kontratë janë juridikisht të detyrueshme vetëm nëse nuk janë në kundërshtim me ligjin, bëhen me shkrim, janë në pajtim me qëllimet origjinale të kësaj kontrate, nënshkruhen nga përfaqësuesit e autorizuar të palëve si dhe i bashkëngjiten kësaj kontrate.

23.5 Kamata për vonesë

Pala e cila është në vonesë me pagesën e ndonjë shume e cila duhet paguar sipas kësaj kontrate ka për detyrë të paguajë kamatën në shumën në fjalë në lartësi prej EURIBOR plus 3% në vit ose kamatën e cila kërkohet me ligj. Kamata llogaritet në bazë ditore që nga data kur pagesa duhet të kryhet deri në ditën kur shuma së bashku me kamatën paguhet në tërësi nga pala e cila është në vonesë.

23.6 Mospërfitimi nga palë të treta

Kjo kontratë lidhet vetëm për dobinë e Komunës dhe të koncesionarit, dhe asnjë person tjetër nuk ka ndonjë të drejtë sipas kësaj kontrate, përveç nëse në kontratë përcaktohet ndryshe.

23.7 Ndarja e dispozitave

23.7.1 Në rast se ndonjë dispozitë e kësaj kontrate shpallet tërësisht ose pjesërisht e pavlefshme ose e paekzekutueshme, atëherë dispozitat tjera vazhdojnë të jenë të vlefshme dhe të ekzekutueshme, ndërsa palët kanë për detyrë të pajtohen me mirëbesim dhe sa më parë që është e mundshme për zëvendësimin e dispozitës së pavlefshme, e cila duhet të jetë e tillë që të arrijë qëllimet e kontratës dhe të prodhojë efektin e barasvlershëm ekonomik.

23.7.2 Dispozita zëvendësuese zbatohet nga dita që kur dispozita e zëvendësuar është bërë e pavlefshme ose e paekzekutueshme. Nëse palët nuk mund të arrijnë marrëveshje lidhur me këtë, atëherë secila palë ka të drejtë të invokojë procedurat për zgjidhjen e kontestit sipas kësaj kontrate.

23.8 Tatimet

23.8.1 Të gjitha pagesat që duhet të kryhen sipas kësaj kontrate kryhen pa zbritur ose mbajtur çfarëdo forme të tatimit. Nëse Komuna ose koncesionari është i detyruar sipas ligjit të zbres ose të mbajë ndonjë tatim, atëherë Komuna, përkatësisht koncesionari, ka për detyrë të zbres tatimin nga pagesa dhe ka për detyrë ta rris shumën që duhet paguar për shumën të cilën Komuna, përkatësisht koncesionari, do ta kishte pranuar po të mos ishte zbritur apo mbajtur tatimi. Nëse Komuna ose koncesionari ka për detyrë të zbres ose të mbajë ndonjë shumë nga pagesa të cilën ka për detyrë ta kryej, atëherë ka për detyrë që Komunës, përkatësisht koncesionarit t'ia dërgojë faturën zyrtare ose ndonjë dokument tjetër me të cilin dëshmohet pagesa e shumës së zbritur apo mbajtur.

23.8.2 Koncesionari ka për detyrë të paguaj të gjitha tatimet dhe taksat administrative që kërkohen sipas ligjit për nevojat e pëmbushjes së kësaj kontrate.

23.9 Njoftimet

23.9.1 Çdo njoftim ose korrespondencë që duhet të bëhet sipas kësaj kontrate duhet të dorëzohet personalisht ose të dërgohet me postë rekomandë ose me telefaks. Adresa për dërgimin e njoftimeve dhe korrespondencave janë të shënuara më poshtë, përveç nëse palët caktojnë me shkrim ndonjë adresë tjetër.

Për koncesionarin:

[vendoset adresa]

Për Komunën:

[vendoset adresa]

23.9.2 Njoftimi konsiderohet i pranuar nga pala në rastet vijuese:

- (i) nëse dorëzohet personalisht, njoftimi konsiderohet i pranuar në ditën kur është dorëzuar;
- (ii) nëse dërgohet me postë rekomandë, njoftimi konsiderohet i pranuar në ditën e tretë të punës pas datës që mban vula postare; dhe
- (iii) nëse dërgohet me telefaks, njoftimi konsiderohet i pranuar në datën e konfirmimit të dërgimit.

23.9.3 Të gjitha njoftimet, korrespondencat dhe komunikimet midis Komunës dhe koncesionarit lidhur me këtë kontratë ose projektin duhet të jenë në gjuhën shqipe, serbe ose angleze.

23.10 Gjuha

Kjo kontratë është e përpiluar në gjuhën shqipe. Në rast të një mospërputhje midis versioneve të ndryshme gjuhësore, teksti në gjuhën shqipe ka epërsi.

23.11 Kufizimi i përgjegjësisë

Kurdo që me këtë kontratë kërkohet kompensimi i një dëmi, asnjëra palë nuk është përgjegjëse për t'ia kompensuar palës tjetër fitimin e humbur, përveç nëse me kontratë përcaktohet ndryshe.

23.12 Përfundimi i përgjegjësisë

Koncesionari pranon se para nënshkrimit të kësaj kontrate e ka bërë një vlerësim të pavarur të vëllimit të punëve dhe shërbimeve që duhet të kryhen, të vendndodhjes, të specifikacioneve dhe standardeve përkatëse të projektit, të kushteve vendore, të kërkesës së mundshme, si dhe të informacioneve që janë vënë në dispozicion nga Komuna. Koncesionari pranon, se e ka vlerësuar natyrën dhe vëllimin e vështirësive dhe rreziqeve që mund të shfaqen gjatë përbushjes së detyrimeve të koncesionarit sipas kësaj kontrate. Koncesionari pranon rrezikun e pasaktësisë ose gabimit të ndonjë çështje të përcaktuar në dokumentet e tenderimit dhe të çdo informacioni tjetër i cili është vënë në dispozicion nga Komuna në lidhje me projektin dhe pajtohet që Komuna nuk mban përgjegjësi për dokumentet e tenderimit dhe informacionet tjera që ia ka vënë në dispozicion koncesionarit ose ndonjë personi tjetër.

NENI XXIV-SHTOJCAT

1.Shtojcat vijuese janë pjesë përberese të kësaj kontratë:

- SHTOJCA 1. Vendndodhja PZ PPP-09-13
- SHTOJCA 2. Specifikimet e punimeve instaluese
- SHTOJCA 3. Shërbimet e kërkuara
- SHTOJCA 4. Standardet e shërbimit
- SHTOJCA 5. Indikatorët kyç të performancës
- SHTOJCA 6. Çertifikata për përfundimin e punëve fillestare
- SHTOJCA 7. Çertifikata për përfundimin e punëve finale instaluese
- SHTOJCA 8. Çertifikata për posedimin e qetë
- SHTOJCA 9. Opinioni ligjor i koncesionarit
- SHTOJCA 10. Plani i tarifave të ofrimit të shërbimit

SHTOJCA 1

Lokacioni i varrezave të reja, Landovicë, Prizren

Zona, rrethina dhe lidhjet

Lokacioni i cili është paraparë për varrezat e qytetit të Prizrenit gjindet në pjesën veriore të qytetit të Prizrenit në vendin e quajtur Qepurec në kufi me fshatin Landovicë, në ngastrën kadastrale me nr. 90 dhe me kulturë arë.

Pronësia e parcelës

Sipas Listës Poseduese nga Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër parcela me numër 90 ka sipërfaqe 57ha 55ari e 24m² dhe është pronë e KK Prizren me vendimin Nr. 01/011-3781, të datës 17 Korrik 2008.

Sipërfaqja e zonës


Lokacioni ka sipërfaqe 57ha 55ari e 24m².

Destinimi i lokacionit

Sipas të dhënave kadastrale parcela ka qenë me shfrytëzim vreshte, kurse tani është e pashfrytëzuar si hapësirë.

Lokacioni ka sipërfaqe të pa ndërtuar, përshkohet nga rruga e paasfaltuar e cila shfrytëzohet nga banoret e fshatrave përreth.

Nga incizimet gjeodezike del se distanca ndërmjet izoipses në pjesën më të lartë është 363m kurse në pjesët më ulët është 393m lartësi mbidetare.



Incizimet gjeodezike në lokacionin ekzistues

SHTOJCA 2

SPECIFIKIMET E PUNËVE INSTALUESE

Struktura fizike e lokacionit

Lokacioni ka sipërfaqe të pa ndërtuar, përshkohet nga ruga e paasfaltuar të cilat shfrytëzohen nga banoret e fshatrave përreth. Nga incizimet gjeodezike del se distance ndërmjet izoipses në pjesën më të lartë është 363m kurse në pjesët më ulët është 393m lartësi mbidetare.

Nga incizimet gjeodezike del që lokacioni ka një pjerrtësi të konsiderueshme, në 40% të prerjes tërthore dhe në 20% të prerjes gjatësore.



Prerja terthore e lokacionit



Prerja gjatësore e lokacionit

NDARJA E LOKACIONIT				
	Destinacioni	NJËSIA	SIPËRFAQJA	PËRQINDJA
1	VARREZAT MUSLIMANE	ha	50,11	84%
		m ²	501116,16	
2	VARREZAT KATOLIKE	ha	4,856	8%
		m ²	48560,72	
3	VARREZAT ORTODOKSE	ha	4,751	8%
		m ²	47516,56	
Total sipërfaqe			59,717	100%

SHFYTËZUESHMËRIA E LOKACIONIT					
		NJËSIA	SIPËRFAQJA	SIPËRFAQJA E SHFRYTËZUESHME	PËRQINDJA
1	VARREZAT MUSLIMANE	ha	50,11	26,45	53%
		m ²	501116,16	264863,62	

2	VARREZAT KATOLIKE	ha	4,856	3,687	75%
		m ²	48560,72	36875,4	
3	VARREZAT ORTODOKSE	ha	4,751	2,385	50%
		m ²	47516,56	23854,82	
Total sipërfaqe e shfrytëzueshme				32,522	100%

Tabela e sipërfaqeve		
Hapësira	Destinimi	Sipërfaqja m ²
	Hapësira e varrezave	278000
	Komunikacioni automobilistik dhe këmbësorë, parkingjet, sipërfaqet gjelbruese, rrjeta e kanaleve, dhe objektet tjera infrastrukturore	49000
	Objektet administrative dhe fetare	1200
Gjithsejt:		328200

Karakteristikat e organizimit të hapësirës

Ndarja e hapësirës bazohet në principin e hierarkisë dhe funksionit të organizimit të territorit. Hapësira ndahet në:

- njësi implementuese
- blloqe

Bllloqet e Varrezave:

Në kuadër të hapësirave për varreza janë paraparë:

Varreza të veçanta - këto varreza organizohen në bazë të dimensioneve me norma të caktuara për varreza për të rritur, për fëmijë, çifte, etj, me dimensione dhe normative të dalta nga plani si dhe aspekti religjioz.

Varreza familjare apo grupore: këto varreza organizohen në bazë të ndarjes së lokacionit të caktuar nga familjet apo grupe të veçanta.

Kushtet e veçanta: Rregullimi i varreve bazohet në karakterin religjioz dhe në bazë të renditjes dhe organizimit të paraqitur në mënyre grafike (raster implementues, dimensionet, vija rregullative, renditja). Në kuadër të këtij blloku janë paraparë hapësira për rite fetare, oaze gjelbruese, çeshme, ulëse, etj.

Bllloqet e varrezave memoriale:

Sipas normativave për projektimin e varrezave ky bllok është paraparë të përmbajë kompleks të varrezave memoriale dhe VIP (personave të rëndësishëm që në veprimtarinë e tyre kanë qenë të rëndësishme si politikan, artiste, shkencëtarë, ushtarë, etj.)

Bloku është planifikuar të trajtohet në mënyrë të veçantë me hapësirë më të madhe në mënyrë të krijohet hapësirë për numër më të madh të pjesëmarrësve si në varrime, përkujtime dhe memoriale të ndryshme.

Kushtet e veçanta:

Hapësira duhet të ketë karakter të veçantë dhe të parashih hapësirë qendrore për tubime dhe memoriale dhe të ketë lidhje të drejtpërdrejtë me objektin, të ketë sipërfaqe gjelbëruese, oaza gjelbërimi të veçanta, ndarje të veçantë të varrezave si dhe karakter të veçantë të organizimit të varrezave.

Biltoqet e objektit administrative dhe religjioz:

Kushtet e përgjithshme:

Objektet përcjellëse duhet të parashihen me dimensione bazuar në kërkesat e funksionit të objektit.

Forma e objekteve duhet bazuar në karakterin religjioz. Përmbajtja e objektit duhet të parashih: morgun, depo dhe hapësira komunikuese, administrata me hapësira përcjellëse, dyqane për shitjen e luleve, shërbime për organizimin e varrimit, hapësira për mirëmbajtjen e lokacionit.

Kushtet e veçanta:

Arkitektura, dimensionimi, lartësia e objektit duhet të ketë karakter religjioz dhe të plotësoj kërkesat funksionale. Në kuadër të këtij blloku duhet të parashihet hapësira për rite fetare e hapur në formë alltari apo edhe amfiteatri ku bëhet tubimi për përshëndetjet e fundit dhe kryerjen e riteve fetare.

Rregullat kryesore të implementimit:

• Parimet e përgjithshme:

Rregullimi i lokacionit përcaktohet me këtë plan dhe bazohet në sistemin e elementeve të rregullimit dhe atë:

- rregullat urbanistike të vijave rregullative (parcelës, zonës, bllokut, njësisë implementuese), vijave të boshtit të rrugës si dhe vijës kufitare të bllokut. Sistemi i raporteve urbanistike, rregullon parimet e rregullimit të hapësirës (vendosja e objekteve, vendosja e varrezave, distance në mes tyre, vendosja e rrethojave, parkimi, dhe të tjera).

• Treguesi Urbanistik shërbejnë për kontrollin e hapësirës dhe kualitetit të raporteve. Treguesit themelor urbanistik janë: vija rregullative, vija ndërtimore për blloqet ku janë të parapara objektet.

Plani i propozuar i implementimit

	Sipërfaqe bruto ari	Sipërfaqe neto Ari	Sipërfaqe bruto m ²	Sipërfaqe neto m ²	Numri i varrezave/ Destinacioni
Varrezat e Komunitetit Musliman					
Njësia implementuese A					
Blloku A-01	74,49	61,12	7449,18	6112,33	Blloku i administrates
Blloku A-02	72,9	66,96	7290,04	6696,4	764
Blloku A-03	83,26	76,82	8326,54	7682,53	826
Blloku A-04	46,59	41,97	4659,17	4197,5	465
Blloku A-05	48,21	43,51	4821,69	4351,01	478
Blloku A-06	83,9	77,3	8390,22	7730,6	89
Blloku A-07	69,21	63,42	6921,76	6342,06	664
Blloku A-08	79,49	73,17	7949,84	7317,73	809
Blloku A-09	29,7	27	2970,4	2700,1	330
Blloku A-10	39,29	35	3929,18	3500,69	396
Blloku A-11	62,27	56,79	6227,72	5679,21	568
Blloku A-12	71,27	64,66	7127,47	6466,54	584
Blloku A-13	47,47	42,49	4747,19	4249,69	456
Blloku A-14	44,33	39,58	4433,65	3958,86	448
Njësia implementuese B					
Blloku B-01	81,6	75,29	8168,65	7528,1	780
Blloku B-02	58,54	53,28	5854,94	5328,41	604
Blloku B-03	59,09	53,79	5909,08	5379,65	598
Blloku B-04	79,03	72,5	7903,35	7250,82	780
Blloku B-05	43,5	39,05	4350,09	3905,54	Blloku i varrezave memorial
Blloku B-06	47,27	42,55	4727,83	4255,05	469
Blloku B-07	49,66	44,87	4966,49	4487,8	493
Blloku B-08	83,17	74,66	8317,58	7466,41	816
Blloku B-09	57,26	52,05	5726,46	5205,79	551
Blloku B-10	58,57	53,29	5857,01	5329,89	600
Blloku B-11	95,67	88,61	9567,18	8861,82	444
Blloku B-12	43,21	38,54	4321,14	3854,59	424
Blloku B-13	39,39	35	3939,99	3500,89	362
Blloku B-14	40,32	35,88	4032,25	3588,51	395
Njësia implementuese C					
Blloku C-01	36,31	32,18	3631,32	3218,87	336
Blloku C-02	33,26	29,31	3326,9	2931,55	342
Blloku C-03	38,69	34,21	3869,93	3421,07	352
Blloku C-04	37,76	33,56	3776,84	3356,76	117
Blloku C-05	29,32	25,45	2932,34	2545,94	306
Blloku C-06	45,29	40,45	4529,92	4045,86	444
Blloku C-07	28,16	24,46	2816,92	2446,19	274
Blloku C-08	29,96	26,19	2996,96	2619,88	346
Blloku C-09	34,5	30,37	3450,01	3037,15	340
Blloku C-10	34,14	30,12	3414,78	3012,39	312

R.G 

	Sipërfaqe bruto	Sipërfaqe neto	Sipërfaqe bruto	Sipërfaqe neto	Numri i varrezave/ Destinacioni
Blloku C-11	24,31	29,67	2431,28	2967,92	204
Blloku C-12	52,37	47,04	5237,66	4704,44	526
Blloku C-13	48,75	43,7	4875,83	4370,44	448
Blloku C-14	39,6	34,57	3960,88	3457,32	348
Blloku C-15	45,74	41,07	4574,65	4107,13	432
Blloku C-16	43,85	39,14	4385,54	3914,33	422
Varrezat e Komunitetit Katolik					
Njësia implementuese A					
Blloku A-01	53,75	45,11	5375,08	4511,99	Blloku i administrates
Blloku A-02	25,37	21,6	2537,04	2160,66	296
Blloku A-03	43,74	38,33	4374,34	3833,16	520
Blloku A-04	35,23	30,96	3523,04	3096,06	402
Blloku A-05	39,56	35,09	3956,34	3509,62	493
Njësia implementuese B					
Blloku B-01	46,6	41,75	4660,87	4175,76	Blloku i varrezave memorial
Blloku B-02	47,09	42,42	4709,97	4242,03	546
Varrezat e Komunitetit Ortodoks dhe të tjerë					
Njësia implementuese A					
Blloku A-01	33,15	29,29	3315,41	2929,34	382
Blloku A-02	35,13	30,82	3513,42	3082,66	421
Blloku A-03	44,7	40,17	4470,46	4017,31	456
Blloku A-04	40,38	35,99	4038,96	3599,58	436
NJËSIA IMPLEMENTUESE B					
Blloku B-01	38,05	30,63	3805,1	3063,95	Blloku i administrates
Total nr i varreve					23694

Për më tepër, shih planin detal.

SHTOJCA 3

Shërbimet e kërkuara

2.1 Shërbimet

Operatori privat do të ofrojë këto shërbime primare

- Shërbimi i varrimit;
- Mirëmbajtja e përgjithshme (rugët, dritat, vendparkimet e të ngjashme)
- Mirëmbajtja e pastërtisë (gjatë të gjitha stinëve, përfshirë pastrimin e borës, etj)
- Mirëmbajtja e pjesës së gjelbëruar të lokacionit
- Sigurimi i përgjithshëm i varrezave dhe objekteve

2.2 Cilësia e shërbimeve

Cilësia e shërbimeve që do të ofrohen është e definuar në standardet e shërbimit të definuara në rregulloren për varrimin dhe mirëmbajtjen e varrezave.

Standardet e cilësisë që duhen definuar duhet të përfshijnë këta komponentë:

- Përpikëria
- Pastërtia

SHTOJCA 4

STANDARDET E SHËRBIMIT

2.3 Kushtet që duhet përmbushur nga operatori privat

Kontrata për koncesionim të shërbimeve duhet të përfshijë kushte specifike për kontraktorin:

- Sistemi specifik i planifikimit
- Kërkesat për trajnimin e punëtorëve
- Mbajtja e shënimeve për ankesat e klientëve
- Fokusi në mjedisin e punës
- Takimet e rregullta ndërmjet operatorit dhe autoritetit përgjegjës
- Rregullat për databazën e të dhënave

2.4 Treguesit e performansës

Treguesit kyç të performansës që do të përfshihen janë:

- Standardet e cilësisë:
 - Rregullsia e shërbimit: përmbushja e kërkesave për shërbim të varrimit në kohën e paraparë (brenda __ orëve)

- Adresimi i ankesave
- Pastërtia dhe mirëmbajtja e rrugëve (gjatë verës dhe dimrit)
- Pastërtia e pjesës së gjelbërt
- Shkathësitë e personelit që merret me menaxhim e varrezave, trajnimi, uniformat, sjelljet
- Kënaqësia e klientëve
 - Rezultatet e hulumtimit të kënaqësisë së klientëve.
 - Numri i ankesave minimale: __

Standardet e shërbimit:

1. Operatori duhet të ketë staf të kualifikuar menaxhues.
2. Faktet rreth kualifikimeve të stafit (diplomat, etj) duhet ti bëhen të ditura Autoriteti Kontraktues
3. Operatori duhet të respektojë privatësinë dhe ceremonitë fetare dhe familjare të klientëve
4. Duhet siguruar zbatimimi i kodit të sjelljes për stafin e operatorit.
5. Instalimi në objekt dhe përdorimi në çdo kohë i arkave fiskale, pajisjeve të faturimit dhe i pajisjeve tjera të kontabilitetit dhe i formave të nevojshme për regjistrim të duhur të aktiviteteve
6. Operimi i koncesionit të shërbimit me staf të mjaftueshëm për të siguruar që kontrata është në pajtim me kërkesat operacionale të marrëveshjes së koncesionit.
7. Kontraktuesi implementon planin e informimit të qytetarëve rreth varrezave të reja në datën efektive të marrëveshjes së koncesionit.
8. Kontraktuesi përgjigjet pa vonesë me shkrim ndaj të gjitha ankesave dhe ato ankesa do të ruhen nga kontraktuesi gjatë kohëzgjatjes së kontratës. Kontraktuesi mund të kërkojë që ankesat të dorëzohen me shkrim dhe të refuzojë reagimin formal deri në pranimin e ankesës me shkrim.
9. Sigurimi i të gjitha licencave dhe autorizimit për operim nga Autoriteti Kontraktues dhe juridiksionet tjera që janë të nevojshme për zbatimin e ligjshëm të kësaj marrëveshjeje të koncesionit.
10. Kontraktuesi nuk do të përfshihet në aktivitete të biznesit pa aprovimin specifik me shkrim nga Autoriteti Kontraktues, përveç për aktivitetet e lejuara shprehimisht sipas kësaj kontrate.
11. Kontraktuesi kërkon nga të gjithë punonjësit që të mbajnë uniformë (ose të kenë një kodë veshjeje të përshtatshëm për përgjegjësitë e operatorit) gjatë kohës sa janë në detyrë. Tridhjetë (30) ditë para nisjes së marrëveshjes së koncesionit, kontraktuesi siguron përshkrimin e specifikimeve të uniformës/kodit të veshjes, që përfshin materialin e propozuar, ngjyrën dhe stilin e veshjeve për meshkuj dhe femra.
12. Gjatë tërë kohës së shërbimit, menaxhmenti, mbikëqyrësit dhe personeli tjetër në kontakt direkt me publikun (pa marrë parasysh sa minimal është kontakti) do të mbajnë tiketat me emrin e tyre në pjesën e jashtme të veshjeve që tregon qartë emrin e kompanisë dhe emrin e titullin e punonjësit.
13. Tarifat publikohen dhe shfaqen në mënyrë të dukshme për të gjithë qytetarët të cilët kërkojnë shërbimet e varrimit, së bashku me kushtet tjera të operimit.

SHTOJCA 5

INDIKATORËT KYÇ TE PERFORMANCËS

Partneri privat do të ofrojë shërbimet e parapara me kontratë në pajtim me indikatorët kyç të performancës si më poshtë:

KATEGORIA	INDIKATORI I PERFORMANCES (TP)
Gatishmëria e ofrimit të shërbimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Operatori duhet të jetë në gjendje që në çdo kohë (brenda orarit të punës) të ofroj shërbimet e kërkuara nga klientët ▪ Operatori duhet të siguroj qasje për mjetet transportuese për qasje në lokacionin e varrezave
Siguria	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ofrimi i sigurisë së varrezave gjatë gjithë kohës, si nga faktori njerëzor, poashtu edhe nga kafshë të ndryshme ▪ Numri i incidenteve në muaj ▪ Respektimi i sistemit të emergjencës (kontroll vetë-vlerësuese) ▪ Përputhja me standardet e qasjes së personave me aftësi të kufizuara
Mirëmbajtja e Aseteve	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Mirëmbajtja e rrethojës, parkingut të makinave, dritave, rrugëve, trotuareve
Shërbimi ndaj klientit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ankesat për muaj / përgjigjet ndaj tyre ▪ Përputhja me standardet e pastrimit (auditimi i vetë vlerësuar) ▪ Kontrollat e klientit misterioz ▪ Anketa e kënaqësisë 12 mujore e klientit

SHTOJCA 6

CERTIFIKATA PËR PËRFUNDIMIN E PUNËVE FILLESTARE INSTALUESE

Në bazë të nenit 6.3.2 të kontratës së koncesionit të dates [...] të lidhur midis Komunës së Prizrenit ("dhënësi i grantit") dhe [...] ("Koncesionari"), dhënësi i grantit vërteton se me datën [...] ("Data e Përfundimit të Punëve Fillestare Instaluese") Koncesionari i ka përfunduar të gjitha punët fillestare instaluese në pajtim me kontratën e koncesionit, duke përfshirë edhe specifikimet e punëve instaluese.

[Vendi], [Data]

Për Komunën e Prizrenit

SHTOJCA 7

CERTIFIKATA PËR PËRFUNDIMIN E PUNËVE FINALE INSTALUESE

Në bazë të nenit 6.3.2 të kontratës së koncesionit të dates [...] të lidhur midis Komunës së Prizrenit ("Komuna") dhe [...] ("Koncesionari"), Komuna vërteton se me datën [...] ("Data e Përfundimit të Punëve Instaluese") Koncesionari i ka përfunduar të gjitha punët instaluese në pajtim me kontratën e koncesionit, duke përfshirë edhe specifikimet e punëve instaluese,.

[Vendi], [Data]

Për Komunën e Prizrenit

SHTOJCA 8

CERTIFIKATA PËR POSEDIMIN E QETE

Kjo certifikatë i referohet kontratës së koncesionit të datës [...] të lidhur midis Komunës së Prizrenit ("dhënësi i grantit") dhe [...] ("Koncesionari").

Komuna vërteton posedimin e papenguar, siç është përkufizuar në kontratën e koncesionit, në dobi të koncesionarit me efekt nga [data efektive].

[Vendi], [Data]
KOMUNA E PRIZRENIT

Emri:

Titulli:

SHTOJCA 9

OPINIONI LIGJOR I KONCESIONARIT

Për Komunën e Prizrenit

Lënda: Partneritet-Publiko-Privat – Varrezat e reja të qytetit, Landovicë

Të nderuar,

Ne jemi angazhuar si këshilltar juridik për [...] ("Koncesionari") në lidhje me partneritetin publiko-privat për ndërtimin e varrezave të reja për Komunën e Prizrenit, në Landovicë..

Ky mendim juridik dorëzohet në bazë të nenit 5.2.6 të kontratës së koncesionit të dates [...] dhe të lidhur midis Komunës së Prizrenit dhe Koncesionarit.

Për nevojat e dhënies së mendimit juridik si më poshtë, ne i kemi shqyrtuar dokumentet e cekura në Shtojcën I.

Duke marrë parasysh komentet dhe cilësimet e mëposhtme, si dhe pas shqyrtimit të çështjeve ligjore dhe kryerjes së hulumtimeve faktike të cilat i kemi konsideruar të nevojshme për dhënien e këtij mendimi juridik, ne mendojmë që:

- (i) Nënshkrimi i kontratës së koncesionit nga Koncesionari si dhe përmbushja e detyrimeve që rrjedhin për Koncesionarin sipas kësaj kontrate është autorizuar në mënyrë të rregullt nga të gjitha organet korporative, aksionarët, si dhe organet përkatëse publike, si dhe nuk është në kundërshtim me ligjin në fuqi në Kosovë.
- (ii) Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në Shtojcën II, sipas ligjit në fuqi në Kosovë nuk kërkohet nga Koncesionari asnjë autorizim, pëlqim, miratim, ose regjistrim nga ndonjë autoritet publik qëndror ose komunal të Republikës së Kosovës (në tekstin vijues "autoritet publik") për nevojat e hyrjes në ose përmbushjen nga Koncesionari të detyrimeve të tij sipas kontratës së koncesionit.
- (iii) Hyrja në dhe përmbushja nga Koncesionari e detyrimeve dhe përgjegjësisive që rrjedhin nga kontrata e koncesionit, si dhe hyrja e Koncesionarit në transaksione të tjera që kërkohen sipas kontratës së koncesionit, nuk janë dhe nuk kanë me qenë në kundërshtim me ligjin në fuqi të Kosovës.
- (iv) Të gjitha autorizimet, pëlqimet, licencat, miratimet si dhe regjistrimet e nevojshme pranë autoriteteve publike janë marrë, përkatësisht janë kryer, si dhe të gjitha kushtet ligjore janë plotësuar që (a) Koncesionari të hyjë në dhe të përmbushë të drejtat dhe detyrimet sipas kontratës së koncesionit, (b) të sigurohet që detyrimet e Koncesionarit sipas kontratës së koncesionit janë të vlefshme dhe të përbarueshme sipas procedurave përkatëse dhe (c) kontrata e koncesionit të pranohet si dëshmi para një gjykate ose ndonjë autoriteti tjetër qeveritar i cili ushtron kompetencë gjyqësore në Republikën e Kosovës.

- (v) Nuk ka padi ose procedurë tjetër gjyqësore, procedurë arbitrazhi, procedurë administrative, hetim ose kërkesë tjetër para një gjykate, gjykate të arbitrazhit ose autoriteti tjetër publik kundër Koncesionarit ose pronës së tij si dhe, sipas dënjës që kemi pas hulumtimit përkatës, nuk ka rrezik që të ketë të tilla në lidhje me (a) kontratën e koncesionit dhe transaksionet që parashihen sipas këtyre dokumenteve ose (b) veprimet tjera që mund të kenë efekt negativ ndaj Koncesionarit ose projektit.
- (vi) Nuk ka masa paraprake, urdhëra, vendime ose aktgjykime të lëshuara nga ndonjë gjykatë, gjykatë arbitrazhi ose autoritet tjetër publik ndaj Koncesionarit në lidhje me kontratën e koncesionit ose transaksionet që kërkohen sipas dokumenteve të transaksionit.


Sinqerisht,

[Këshilltari ligjor i Koncesionarit]

SHTOJCA 10

PLANI I TARIFAVE TË OFRIMIT TË SHËRBIMIT

NËNSHKRIMI I KONTRATËS

Për Komunën		Për Koncesionarin	
Emri dhe mbiemri i personit të autorizuar për nënshkrim të kësaj kontrate:	<i>Ramadan Muja</i>	Emri dhe mbiemri i personit të autorizuar për nënshkrim të kësaj kontrate:	<i>REKHEP GASHI</i>
Data dhe vendi	<i>23.2.2017</i>	Data dhe vendi	<i>22.02.2017</i>
Nënshkrimi i personit të autorizuar		Nënshkrimi i personit të autorizuar	
Vula		Vula	




CERTIFIKATA PËR POSEDIMIN E QETË

Kjo certifikatë i referohet kontratës së koncesionit: **Partneriteti Publiko Privat, Varrezat e Reja në Fshatin Landovicë të Prizrenit**, me numër të prokurimit publik: PPP-16-085-611, të datës 23.02.2017 të lidhur midis Komunës së Prizrenit (“dhënësi i kontratës”) dhe PZ Group shpk (“Koncesionari”).

Komuna vërteton posedimin e papenguar të lokacionit të paraparë për implementimin e projektit, siç është përkufizuar në kontratën e koncesionit, neni 6.3. si parakusht i dhënësit të kontratës, në dobi të koncesionarit me efekt nga data 12.03.2025

Prizren, 12.03.25
KOMUNA E PRIZRENIT


z. Shaqir Totaj
Kryetar i Komunës së Prizrenit






CERTIFIKATA PËR PËRFUNDIMIN E PUNËVE FILLESTARE INSTALUESE


Në bazë të nenit 6.3.2 të kontratës së koncesionit të datës 23.02.2017 të lidhur midis Komunës së Prizrenit (“dhënësi i kontratës”) dhe PZ Group shpk (“Koncesionari”), dhënësi i grantit vërteton se me datën 12.03.25 (“Data e Përfundimit të Punëve Fillestare Instaluese”), Koncesionari i ka përfunduar të gjitha punët fillestare instaluese në pajtim me kontratën e koncesionit, duke përfshirë edhe specifikimet e punëve instaluese.

Prizren, 12.03.25
KOMUNA E PRIZRENIT


z. Shaqir Totaj,
Kryetar i Komunës së Prizrenit










 REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
 KOSOVA CUMHURIYETI
 Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
 Prizren Belediyesi
 Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
 Belediye Başkanı

VËRTETIMI I DATËS EFEKTIVE

Nr. 137/25 Dt. 12.03.2025

Komuna e Prizrenit, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës z. Shaqir Totaj, dhe kompania PZ Group SH.P.K., e përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv z. Rexhep Gashi, nënshkruajnë vërtetimin që konfirmon plotësimin e parakushteve në kontratë (neni 6.2) dhe caktojnë “datën efektive” të kontratës (sipas nenit 6.4).

Data efektive nënkupton kur të gjitha parakushtet paraprake të përcaktuara në nenin 6 janë përmbushur ose është hequr dorë nga përmbushja e tyre, gjë që dëshmohet me nënshkrimin nga palët, të certifikatës së datës efektive.

Për Komunën e Prizrenit		Për Koncesionarin	
Emri dhe mbiemri i personit të autorizuar për nënshkrim të kësaj kontrate:	z. Shaqir Totaj	Emri dhe mbiemri i personit të autorizuar për nënshkrim të kësaj kontrate:	z. Rexhep Gashi
Data dhe vendi	<u>12/03/25</u> Prizren	Data dhe vendi	<u>12/03/2025</u> Prizren
Nënshkrimi i personit të autorizuar	 	Nënshkrimi i personit të autorizuar	 
Vula		Vula	